

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7816 E diel 10 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Më 14 shtator 1998, një gazetar i RAI DUE, një stacioni televiziv shtetëror italian raportonte nga Tirana se kryeqyteti ishte në mes të një lufte civile, mes ...
Vijon në faqen 21

Nga FATOS ÇOÇOLI

Nga Shqipëria: asgjë e re nga lufta virtuale civile



Opinion i Ditës

Shumica kurrë s'është e drejtë. Asnjëherë, këtë ua them unë! Kjo është një nga ato lloj gënjeshtërash në shoqëri që nuk e ndihmon dot as edhe një njeri ...
Vijon në faqen 22

Nga BEN ANDONI

Rama duhet ruajtur nga deliri?!



BalkanW

Protesta e Fierit, 4 të arrestuar e 41 të proceduar

U nis për në protestën e 5 marsit në Tiranë, gjobitet si taksist kreu i PD në Gramshit

Kodhel Çala: Isha me 4 miq. Rama: Nuk i dorëzohem "100 petritëve të Saliut"

Kryetari i Partisë Demokratike të Gramshit, Kodhel Çala është gjobitur nga policia si taksist. Mësohet se ngjarja e pazakontë ka ndodhur disa ditë më parë. Marrja në makinën personale e 4 miqve të tij, përfaqësues të tjerë të PD-së në Gramsh dhe udhëtimi drejt Tiranës më 5 mars, i ka kushtuar një gjobë të majme dhe daljen në komision. Çala është ndaluar nga ...
Në faqet 2-3

KREU I ALUIZNI-T: 80% E PRONAVE TE RREGJISTRUARA REZULTOJNE ME GABIME

ARTAN LAME: JA PRONARET QE FITOJNE NGA AMNISTIA

"Falen kamatëvonesat e qytetarëve që nga viti 1994. Ligji "Për Kadastrën" hyn në fuqi më 22 Mars më pas nis procesi i strukturimit"



(Në foto) Kreu i ALUIZNI-T, Artan Lame

Në faqen 7

VENDIMI I PD

Basha konfirmon Mziun për Kamzën. "Rruga e kombit", Do ia heqim taksën
Në faqen 5

OPERACIONI

Pranga boksierit të "Vllaznisë", pjesë e grupit kriminal "Bajri"
Në faqen 8

DENIMI EKSTREM

Dom Shtjefën Kurti, kur raportohej nga "Shigjeta", "Drita" dhe "Shëndeti"
Në faqen 9

LEVIZJET NE POLICI

Largohet nga detyra kreu i Policisë Vlorë, në vend të tij "shefi i përgjimeve"
Në faqen 8

LISTA E PLOTE



Dosjet 1993-2013, lista me 6 611 pronarët që do të marrin paratë
Në faqet 10-12

Karikatura shqiptare merr një ndër tre çmimet e Serbisë në konkursin ndërkombëtar

"Shteti shqiptar, si duhej të administrohej"

Fokusi i Kostandin Ristanit, ushtarak në Ministrinë e Mbrojtjes së Kanadasë

NGA KOSTANDIN RISTANI

Një fjalë e urtë angleze thotë që "knowing the problem is half of the solution" e cila do të thotë që "njohja e problemit është gjysma e zgjidhjes". Duke u nisur nga kjo fjalë shumë



e urtë ky cikël analize shkrimesh është hartuar mbi tri linja kryesore: 1) Përshkrimi i disa nga funksioneve më kryesore të një shteti modern dhe ligjor; 2) Përshkrimi i gjendjes së deritanishëm e nxjerrja në pah e mangësive e ...
Suplement

Suplement

Në faqen 8

KRIZA POLITIKE PERPLASJA

Kryeministri pritet me protesta: Të gatshëm të flasim, dialogojmë për çdo gjë

Rama në Fier: Nuk i dorëzohem "100 petritëve të Saliut"

"S'duan të hyjnë në zgjedhjet e qershorit"

Kryeministrin Edi Rama e pritën sërish me protesta përfaqësuesit e opozitës në ditën e dytë të turit "Bashkia që duam" në Fier, por për të ata janë thjeshtë "100 Petritat" e Berishës që sipas tij partia i ka lënë rrugëve. Në takim z.Rama ironizoi pjesëmarrësit e protestës, duke theksuar se qëllimi është bllokimi i zhvillimit të vendit. "100 petritat e Saliut atje tek kthesa, përfaqësojnë dëshpërimin e madh të Saliut dhe çetës së tij. Ata në kthesë janë, në kthesë do mbeten dhe kthesën nuk kanë për ta marrë dot përsa kohë nuk do të ndahen nga kush i ka marrë peng dhe peng ata nuk i ka marrë as qeveria dhe as PS por koka që nuk di ku i çon. Kë duan të bëjnë për budallenj këta, se mirë kur duan të vijnë në Tiranë mbyllin bashkitë. I fusin në autobusa dhe bashkë me ata që i janë mbyllur lojrat e fatit", theksoi z.Rama.

"MARRËVESHJA"

Kryeministrin Rama i i kujtoi Lulzim Bashës çadrën para zgjedhjeve 2017 dhe marrëveshjen e 2017-ës. Për Ramën është Basha që nuk iu përmbajt marrëveshjes para zgjedhjeve parlamentare. "Ne i morëm në qeveri, dolën nga çadra dhe erdhën në qeveri. Morën çfarë dëshën, ministrinë e Brendshme, ministrinë e Financave, ministrinë e Arsimit, dhe OSHEE. Morën kryetarin e KQZ-së dhe shumicën e KQZ-së si asnjëherë më parë. Për një arsye shumë të thjeshtë merri këto ama nënshkruaj. Lulzim kush fiton qeverisë, kush humbet bën opozitë dhe të gjithë bashkë kemi qkemi në gjuhë të huaj nuk i i bëmë në qafë Shqipërisë", tha kreu i qeverisë. Edi Rama akuzoi se PD po shkakton këtë situatë për shkak se nuk do të dalë në zgjedhjet e qershorit 2019 pasi i druhet humbjes. "Kë duan të bëjnë për budallenj këta, se mirë kur duan të vijnë në Tiranë mbyllin bashkitë. I fusin në autobusa dhe bashkë me ata që i janë mbyllur lojrat e fatit. Kërkojnë ti shmangen qershorit. Nuk duan të balafaqohen në zgjedhjet e qershorit 2019. Këtu e kanë e



Kryeministri i Shqipërisë Edi Rama

kanë gjithë hallin. Duan të krijojnë të gjithë alibinë se zgjedhjet këtu blihen e shiten. Halli tjetër është reforma në drejtësi sepse laku po shtrëngohet dhe dija halle ata i kanë ia di i gjithë populli dhe gjithë Shqipëria", u shpreh z.Rama.

"MANDATET"

Sa i përket djegies së mandateve Rama thekson se opozita është futur në një rrugë pa krye. "Zoti nuk ndërhy në procesin zgjedhor se po të merrje me zgjedhje Monikës do ti kishte rënë rrufeja dhe larg qoftë do kishim mbetur pa doktoreshë. Po kur thonë që këta që hyjnë në parlament janë të Ramës. Po pse unë i vura në lista?! Unë ia kapa Monikës dorën dhe shëno këto në lista?! Apo i mbajta dorën Lulit. Lulini e mora për dore por nuk i mbajta dorën. Dhe tani atyre që i vjen mundësia të bëhen deputetë të marrin rrogë e pension. Ikën nga parlamenti se nuk kanë ide as program. E mendoni dot që kandidati për kryeministër vjen me vezë në xhep?!", theksoi z.Rama. Sa i takon PD-së dhe LSI-së z.Rama tha: "pak nga pak ata do të trefren rrugëve. Nuk e di nëse do futen në zgjedhje apo jo por si ta duan... një gjë është e sigurtë ata nuk fitojnë dot asnjë nga bashkitë që kemi dhe nuk mbajnë dot as gjysmat e atyre që kanë dhe po vazhduan

rrugëve edhe më keq do jetë". Kryeministrin Rama deklaroi se mazhoranca mbetet e hapur për dialog, por nuk negocihet mandati katër vjeçar qeverisës. "Ne jemi të gatshëm të flasim, dialogojmë për çdo gjë", tha Edi Rama.

"ZGJEDHORJA"

Demokratëve ju kujtoi se ka gati Reformën Zgjedhore ku është përfshirë kërkesa e tyre që mbajti ngritur çadrën në bulevardin "Dëshmorët e Kombit", 2 vjet më parë për votim dhe numërim elektronik. "Kemi përgatitur Reformën Zgjedhore, madje ju kujtohet çfarë thoshte Luli? Se varet çfarë kasete fut, atëherë kishte kastën e votimit elektronik se ndryshe nuk bëhet gjë, aq sa na e futi dhe ne në kokë dhe ne kemi bërë testimet dhe hajt ta provojmë dhe ta fusin në zgjedhjet e ardhshme, por ai ka ikur, ka ndërurrar kasete, është e reja tani. Kur këndonte kaseten e jetër, doktoreshën e takonte fshehurazi, kurse tani ajo e mban për krahu, se lë më. Në do vazhdojmë punën tonë. E rëndësishme është se çfarë u tha në zgjedhjet e shkuara janë zotime të mbajtura", deklaroi Rama. Gjatë qëndrimit në qarkun e Fierit inspektori i shoqëruar nga ministria Manastirliu, Qendren e rehabilituar Shëndetësore të Patosit.

REFORMA

"Kemi përgatitur Reformën Zgjedhore, madje ju kujtohet çfarë thoshte Luli? Se varet çfarë kasete fut, atëherë kishte kastën e votimit elektronik se ndryshe nuk bëhet gjë, aq sa na e futi dhe ne në kokë dhe ne kemi bërë testimet dhe hajt ta provojmë dhe ta fusin në zgjedhjet e ardhshme, por ai ka ikur, ka ndërurrar kasete, është e reja tani", tha z.Rama.

Berisha: Fermeri u hedh fasulen deleve se s'ka treg

Ish-kryeministrin Sali Berisha publikoi dje një video-denoncim të qytetarit dixhital, i cili tregon se për shkak të mungesës së tregut, prodhimet bujqësore (fasulet) janë të detyruar t'u nxjerrin blegtorisë. Qytetari dixhital i bën thirrje kryeministrit Rama që të largohet sa më parë, pasi sipas tij, populli nuk e do më atë në krye të qeverisë. "Ah mor Edi Rama more faqezi! E bëjmë mallin dhe nuk e shesim. Kjo që bën nuk është drejtë, prandaj zhdudu sa më parë. Sa të të vrasin njerëzit, ka me të vra edhe buka ime. 100 luga janë mbush me djersën time. Është gjynah se jemi duke u copëtuar. Grosnja ja si qelibar, ta hajë delja është gjynah, prandaj bëjë të pamundurën dhe zhdudu, zhdudu sepse nuk të do më populli", shprehet qytetari.



Protesta e djeshme në Fier

SHKURT

Takimi në Fier, Tabaku: Afera korruptive, Rama kthehet tek vendi i krimin

Ish-deputetja e PD-së, Jorida Tabaku akuzoi dje Kryeministrin Rama për një nga aferat sipas saj më të madhe korruptive. Ajo komentoi dje me një reagim në "Facebook", qëndrimin e shefit të qeverisë, Edi Ramës në qytetin e Fierit. Tabaku duke përmendur inceneratorin e Verrisë në Fier, kujtoi për shqiptarët se ndërtimi i tyre është një nga aferat më të mëdha korruptive të kësaj qeverie. "Kur Rama kthehet në vendin e krimin! Inceneratorët janë një nga aferat korruptive më të mëdha të kësaj qeverie, 178 mln euro pa tender, me procedura antiligjore dhe tërësisht korruptive, të falura një kompanie pa eksperiencë, me aksionerë offshore, pa punonjës e lidhur me pushtetin. Një rast aq evaziv sa që edhe Zëri i Amerikës, që kryeministri e ka pagëzuar tanimë si "kazan" ka folur për të. Për ta kuptuar se sa korruptive është procesi i dhënies së lejeve inceneratorëve mjafton të përmendim se 17 vkm janë dhënë brenda një dite. Për të grabitur para publike që kanë shkuar dhe do të shkojnë në xhepat e Klodian Zotos (por edhe kush fshihet pas tij). Kush ka dyshime për krimin ekonomik (por edhe atë mjedor) le të shohë inceneratorin e Fierit, që do të ndërtohej në fshatin e Verrisë. Janë paguar nga buxheti i shtetit 16 mln euro dhe akoma nuk po hidhet as edhe një tullë. Fshati po zbrazet, njerëzit po ikin, paratë e shqiptarëve i janë paguar firmës së Klodian Zotos por nuk ka shenjë të fillimit të këtij projekti. Projekti i inceneratorëve në Fier rezultoi të jetë fantazmë, ama në Tiranë po realizohet duke u shndërruar në barrë për gjithëkënd. Prandaj kontratat e inceneratorëve do të jenë nga të parat që do të jetë subjekt i ligjit antimafia. Kushdo që ka firmosur, përfituar dhe punuar në dëm të buxhetit dhe qytetarëve do të vihet para ligjit. Fondet do të shkojnë për komunitetin! Rama fatkeqesisht kudo që shkon vetem krim shkakton kete here ekonomik e mjedor. Fieraket prandaj protestojne sot e do protestojne dhe me 16 Mars!", shkruan Jorida Tabaku.



FIER - Një efektivi i Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH) është plagosur paraditen e djeshme gjatë tensioneve me protestuesit e Partisë Demokratike në Fier. Mëohet se policia ka shtyrë protestuesit që ndodheshin pranë vendit ku kryeministri Edi Rama po zhvillonte një takim dhe më pas situata është tensionuar edhe më shumë. Protestuesit kanë goditur me mjete të forta në kokë Aranit Karemanin, i cili qëlluar është dërguar në spital për mjekim dhe ndodhet jashtë rrezikut për jetën. Pas plagosjes së efektivit të FNSH-së në protestën e opozitës ka reaguar zyrtarisht policia, e cila ka bërë me dije se hetimor do të analizojë provat dhe pamjet filmike për të vënë para përgjegjësisë ligjore autorët e sulmit ndaj punonjësit të rendit.

"Sot paradite, në vendin e quajtur "ETC" u grumbulluan për të protestuar rreth 150 protestues me pankarta dhe zhurmues. Gjatë protestës pati tentativa për të çarë kordonin policor; si dhe u goditën me sende të forta

Protesta e së premtes, 4 persona të arrestuar dhe 41 të proceduar

Plagoset efektivi i FNSH-së në tubimin e PD-së, Policia: Autorët do të përballen me drejtësinë



Efektivi i FNSH-së, Aranit Karemani që u plagos në protestën e djeshme

forcat e Policisë. Për pasojë u plagos në kokë një punonjës policie i FNSH-së, i cili po merr ndihmë mjekësore në Spitalin Rajonal Fier. Grupi hetimor do të analizojë provat dhe pamjet filmike për të vënë para përgjegjësisë ligjore autorët e sulmit ndaj punonjësit të rendit", thuhet në njoftimin e policisë. Ndërkaq, policia e Fierit dje bëri me dije se ka arrestuar 4 persona si dhe ka proceduar penalisht 41 të tjerë, pasi të enjten protestuan kundër

qeverisë dhe kryeministrin Edi Rama. Sipas bluve, këta persona akuzohen se kanë marrë pjesë në grumbullime të paligjshme dhe kanë mbajtur të bllokuar rrugën duke penguar lëvizjen e lirë të mjeteve. Në pranga ranë shtetasit: H.H., 59 vjeç; G.B., 56 vjeç; B.J., 56 vjeç dhe B.Xh., 56 vjeç, të katërt banues në Roskovec. Gjithashtu, janë proceduar në gjendje të lirë edhe 41 persona të tjerë për veprën penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në

grumbullime dhe manifestime të paligjshme". Mbeshtetësit dhe simpatizantët e PD-së dhe LSI-së në Fier priten me protesta Kryeministrin Edi Rama, i cili zhvilloi një takim për festën e gruas. Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier për veprat penale "Organizimi dhe pjesëmarrja në grumbullime dhe manifestime të paligjshme" dhe "Pengimi i qarkullimit të mjeteve të transportit".

Kreu demokrat: Kjo është haptas presion që qytetarët të mos dalin në protestë

GRAMSH

Kryetari i Partisë Demokratike të Gramshit, Kodhel Çala është gjobitur nga policia si taksist. Mësohet se ngjarja e pazakontë ka ndodhur disa ditë më parë. Marrja në makinën personale e 4 miqve të tij, përfaqësues të tjerë të PD-së në Gramsh dhe udhëtimi drejt Tiranës më 5 mars, i ka kushtuar një gjobë të majme dhe daljen në komision. Çala është ndaluar nga policia në aksin rrugor Elbasan-Cërrik dhe i është vendosur gjobë nga polici rrugor, me arsyetimin se punonte si taksist ilegalisht. Në një prononcim për "Neës 24" dhe "Gazeta Shqiptare", kreu i PD-së, i cili e ka paguar gjobën tha se kjo është haptas presion për qytetarët që të mos dalin në protestë.

NGJARJA

"Më 5 mars isha nisur për protestë në Tiranë. Kisha në makinën time nënkryetarin e degës, një anëtar të Kryesisë dhe 2 sekretarë seksionesh. Papritur më ndalon patrulla e policisë në afërsi të Cërriku. E ndaloj makinën dhe më kërkohet dokumentet. Ua dhashë. Pasi i verifikoi dhe ishin në rregull, erdhi tek dera polici dhe më tha dil dhe hap bagazhin. Vajta e hapa. E kontrolluan bagazhin nga të gjitha anët, s'kishte gjë për të dyshuar, ndaj e mbylla. Ndërsa, polici u largua dhe diç po shkruante. Unë u afrova dhe i thashë a mund ta di çfarë po shkruani se duhet të më sqaroni. Tha për ju kemi të dhëna

U nis për në protestën e 5 marsit në Tiranë, gjobitet si taksist kreu i PD-së së Gramshit

Kodhel Çala: Isha me 4 miq në makinën time kur më penalizuan. Policët rrugorë, të urdhëruar



Kreu i PD-së së Gramshit, Kodhel Çala



Faksimile e gjobës së paguar nga Çala

që punoni taksist dhe do shkoni në komision. U çudita dhe qesha me vete, e morën vesh dhe ata që kisha në makinë. U thashë se nuk punoj taksist. Unë jam filani, siç e pe tek dokumentet, dokumentet janë të rregullta, unë nuk punoj taksist. Unë po iki për protestë. Jo ne kemi të dhëna që ju puno-

ni taksist, më tha polici. Unë në kam dalë në komision, kam paguar tashmë edhe gjobën. Por çka më bëri përshtypje, ishte se polici kishte një indicie, me sa kuptova", tregoi Kodhel Çala. Ndërkaq, ai shpjegoi më tej se "në të njëjtën ditë kishte plot makinë që udhëtonin drejt Tiranës

edhe për protestë dhe askush nuk i ndaloj, përveç makinës sime. Ndaj e konsideroj të urdhëruar policin që vendosi gjobën dhe heqjen e patentës". **DEKLARATA E KREUT TË PD-SË** Gjithashtu, kreu i PD-së së Gramshit, Kodhel Çala sqaroi se makinën e përdor vetëm ai.

"Këtu e 15 vjet ka që e kam blerë. Unë e kuptova shumë mirë në fakt. Polici kishte marrë një indicie për të trembur protestuesit se shih çfarë bëhet me kryetarin e opozitës në Gramsh, pale me popullin çfarë mund të bëjnë. Por ta kenë të qartë se nuk e ndalin dot askënd që të shkojë në protestë. Në protestë vijnë edhe shumë socialistë. Edhe gjoba të na vënë, edhe patentën të na heqin, ne do ikim edhe në këmbë, sepse popullit i ka vajtur në majë të hundës", tha Çala. Ai deklaroi se të gjithë janë qytetarë, përfshirë dhe komisionin. "Të gjithë janë qytetarë, por edhe në kërkohet janë revoltuar se si është e mundur të arrihet deri këtu. Dhe kjo është thjesht për të ndaluar protestat mbarëpopullore, por duhet ta dinë mirë qeveria në qendër dhe lokale se

zëmëratën e popullit nuk mund ta ndalin më. Unë kam shkuar direkt tek komisioni. Mund të them fjalët më të mira për ata të komisionit dhe ata ngritën supet. "Ç'është kjo thanë, kjo është ashigare, është skandal", kam shumë respekt për ata. Ata thanë nga ta rrotulloni, deri tek minimalja, s'kemi çfarë të bëjmë më tepër", përfundoi Çala. Ai është një ndër figurat më të njohura politike në rrethin e Gramshit. Në vitin 1996 është zgjedhur për herë të parë si kryetar komune në Tunjë, deri në vitin 2015. Në vitin 2015 kandidoi për kreun e bashkisë nga Partia Demokratike. Në vitin 2017 renditet i nënti në listën për deputetë në qarkun Elbasan nga Partia Demokratike. Në vitin 2018 u zgjodh kreu i PD-së në rrethin e Gramshit.

AKSIONI I OPOZITËS PROTESTA

Kryetarja e LSI: Eksponentë të lartë të PS-së të përfshirë në dosjet "339" dhe "184"

Kryemadhi: Zgjedhje të parakohëshme, qeveria në grahamat e fundit

"Heqja dorë nga mandatet, shmangëm përplasjen civile"

Valentina Madani

Kryetarja e LSI-së Monika Kryemadhi organizon dje një takim me strukturat e LSI-së në Gramsh nga ku akuzoi se në Prokurori janë dosjet "339" dhe "184" që sipas saj vërtetojnë përfshirjen e eksponentëve të lartë të PS-së në blerjen e votave. Kryemadhi ftoi qytetarët në protestë, duke theksuar se vetëm në këtë mënyrë i jepet fund varfërisë dhe shpopullimit të vendit. "Janë mbi 300 denoncime të LSI-së në zyrat e OSBE-së, ku denoncojnë jo vetëm blerjen e votës, por dhe përdorimin e bandave kriminale edhe të segmenteve kriminale, së bashku me Policinë e Shtetit në favor të votës për PS-në. Sot në zyrat e Prokurorisë qëndron "Dosja 339", për përfshirjen e eksponentëve të lartë të PS-së, që nga Vangjush Dako dhe pse jo edhe Edi Rama, ku blihen votat me grupet kriminale. Dosja 184, ku ka ministra e deputetë të PS-së të përfshirë në blerjen e votave, por dhe në këmbim të blerjes së votave përkundrejt lejimit të parcelave të hashashit në Bashkinë e Dibrës", deklaroi zj. Kryemadhi. Kryetarja e LSI-së zbardhi arsyet e dorëzimit të mandateve të deputetëve që sipas saj shmangën përplasjen civile. "Ne u gjendim përballë një situatë politike që i vendosi shqiptarët përballë konfrontimit fizik me qeverinë dhe përballë të qenurit një opozitë fasadë që ata mund ta përdorin në mënyrë nga më të ndryshmet. Mu mund ta përdorin si fasadë të qeverisjes ku nuk ndryshonte asgjë, ku nuk hapeshin vendet e reja të punës, ku taksat nuk rriteshin çdo ditë, ku ekonomia rrinëhej çdo ditë, ku shqiptarët varfëroheshin më shumë, ku çdo ditë e më shumë iknin të rinj e të reja. Mund të qëndronim në Parlament. Mund të merrnim rrogën e deputetit dhe bënim sikur bënim opozitë. Mbanim një fjalim një herë në javë kundër qeverisë, por asgjë



Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi

DEKLARAT

Kryetarja e LSI-së, Monika Kryemadhi, tha dje se një ndër arsyet e heqjes dorë nga mandatet, ishte shmangia e përplasjes civile. "Mund të qëndronim në parlament të merrnim rrogën e deputetit të bënim sikur bënim opozitë por asnjë gjë nuk do ndryshonte", tha zj. Kryemadhi.

KQZ njofton dhënien e mandateve, shtohen 6 deputetë të rinj

Të hënën zihen mandatet e Balliut, Strazimirit, Malajt, Tushajt, Veliajt e Tavos

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të zëvendësojë të hënën dhe gjatë deputetë të tjerë të opozitës. Tre prej tyre vijnë nga lista e Partisë Demokratike. Në Berat Astrit Veliajt do të zëvendësohet nga Lefter Balliçi. Në Korçë Klevis Balliu do të zëvendësohet nga Ligoraj Karamele. Ndërsa mandati i Gent Strazimirit do ta marrë Majlinda Halilaj e cila është renditur në numrin 47 në listën e partisë demokratike për kryeqytetin. Sipas relacionit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në datën 1 mars Halilaj ka paraqitur dorëheqjen nga marrja e mandatit, por tre ditë më pas po ashtu në KQZ ajo ka dorëzuar edhe formularin e dekriminalizimit duke nisur procedurën e marrjes së mandatit. Sa i përket LSI mandatin e Viktor Tushajt në Lezhë e merr Alda Hoti, e cila pavarësisht se ka



dorëzuar dorëheqjen nga marrja e mandatit ka paraqitur edhe formularin e dekriminalizimit. Në Durrës mandatin e Nora Malaj e merr Edlira Hyseni dhe në Gjirokastrë në vend të Vangelj Tavos e merr Ediola Braha. Në këtë mënyrë pas së hënës në Kuvend do të ketë 92 deputetë. 143 kandidatë të opozitës në listat e zgjedhjeve të 2017 kanë dorëzuar në KQZ vetëdeklarimin ku refuzojnë të marrin mandatin e deputetit. Deputetët e rinj pritet të betohen

nuk do të ndryshonte. Djegia e mandateve tona erdhi si një veprim ekstrem, por erdhi edhe si një shmangie midis qytetarëve dhe qeverisë. Erdhi edhe si rezultat i shman-

gies së një konflikti trup më trup të qytetarëve me fëmijët e tyre, me vëllezërit e tyre me policinë shqiptare. Djegia e mandateve tona erdhi si një formë sensibilizimi se deri

BETIMI

Deputetët e rinj pritet të betohen në seancën plenare të datës 13 Mars duke e çuar në këtë mënyrë në 10 numrin e mandateve të asaj që cilësohet si opozita e re parlamentare në vend.

në seancën plenare të datës 13 Mars duke e çuar në këtë mënyrë në 10 numrin e mandateve të asaj që cilësohet si opozita e re parlamentare e rradhës KQZ do të regjistrojë katër parti politike si pjesëmarrëse në zgjedhjet e 30 qershorit për pushtetin vendor. Ato janë: Partia Unitet Komëtar, Partia Socialiste e Moderuar, Partia Emigracioni Shqiptar dhe Partia Kombëtare Konservatore Albania.

ku është kalbur sistemi dhe qeverisja shqiptare", theksoi Kryetarja e LSI-së. Kryemadhi pohoi se politika duhet të shihet nga shqiptarët si një instrument, i cili duhet të



Kreu i PD-së Lulzim Basha dje në Paskuqan

SHKURT

Vasili: Të dorëhiqet, zvarraniku Rama dështoi me reformat

Sh-deputeti i LSI-së, Petrit Vasili shprehet se kryeministri Finlandez dhe dorëheqjen për shkak se kishte dështuar në reformën në Shëndetësi ndaj të njëjtën gjë kërkon edhe nga Kryeministri i Shqipërisë. Referuar kësaj, Vasili thekson se Rama e premti shëndetësinë falas dhe nuk u bë kurrë, por ende qëndron në karrigen që ka mbërthyer. Sipas Vasilit, Shqipëria nuk ka nevojë për mashtrues të rëndomtë si Edi Rama, por për punë dhe vepra konkrete. "Kryeministri i Finlandes jep dorëheqjen për një objektivi të përcaktuar: Po zvarraniku Edi Rama?. Kryeministri i Finlandes Juha Sipilä dhe dje dorëheqjen për mosrealizimin e paketës së reformës për shëndetësinë të programit të tij. Sipilä tha: "Qeveria ime punon vetëm mbi një princip: ose rezultate ose dorëheqje. Une jam njeri i parimeve dhe ne politike duhet të marresh përgjegjësi. Dhe une jam duke marrë pjesën time të përgjegjësisë", perfundoi Sipilä. Edi Rama ky kryeministër, që si sëmundje ka pllakosur Shqipërinë, premti Shëndetësinë falas, që nuk e bëri kurrë dhe megjithatë rri atje i mbërthyer në karrige, pa nder dhe pa personalitet. Edi Rama rri në karrige se nuk është as njeriu i parimeve dhe as i përgjegjësive është thjesht një zvarranik i shplare, që zhvat para me horrat dhe flet budallëqë gjithë ditën", shprehet z. Vasili.



vitet në shërbim të tyre për të përmirësuar kushtet ekonomike dhe ato sociale. "Korrupsioni i kryetares së bashkisë në Reskovec është shumë i madh. Vota janë blerë me paratë e drogës. Njerëzit duhet ta shohin

politikën, si një instrument për të përmirësuar jetën e tyre, për të zhvilluar shanset ekonomike. Mos u ndalni, sepse në grahamat e fundit, sa më i madh është presioni, aq më pranë është fundi i tyre", tha Kryemadhi.



Konfirmon Mziun për Kamzën, kreu I PD: Kryebashkiak i fjalës së mbajtur

Protesta, Basha: Qytetarët në varfëri, Rama bresh me charter

"Do heqim taksën e "Rrugës së Kombit"

Valentina Madani

Kreu I opozitës Lulzim Basha apeloj dje për unitet mbarëkombëtar me datën 16 mars. Z.Basha ishte në Paskuqan ku u takua me banorët për të ftuar në protestën e 16 marsit. Ai takoi dhe bizneset e zonës, duke ecur për më shumë se 2 km deri në Babrru. Z.Basha u kërkoi banorëve të Paskuqanit të marrin pjesë masivisht në protestën e 16 Marsit për ta çuar vendin drejt një qeverie tranzitore që do të mundësojë zgjedhje të lira. Pas prezantimit nga kryetari i Bashkisë së Kamzës si Kryeministri i ardhshëm i vendit, Lulzim Basha zgjodhi pikërisht Xhelal Meziun si shembull për të treguar ndryshimin e vizionit mes të zgjedhurve të PD që dinë të mbajnë premtimet dhe Edi Ramës që sipas tij gënjejnë shqiptarët duke i zhytur në varfëri. Kryedemokrati bashkëbisedoi për më tepër se 60 minuta me banorë e sipërmarrës të vegjël të Paskuqanit të cilëve ju premtoi se me ardhjen në pushtet do të ulë taksat, çmimin e energjisë elektrike dhe karburantit.



DEKLARATA
"Oligarkët jetojnë në luks, por edhe Edi Rama bresh me charter në të gjithë botën, ndërsa qytetarët nuk kanë para për një biletë autobusi. Ndryshimi po vjen. Shqipëria i ka mundësitë. Ju e keni në dorë çelësin e ndryshimit. Vende pune për çdo shqiptar dhe veçanërisht për rininë. Pengesa e vetme për Shqipërinë, është njëri që ka harrur vendin" - tha Basha.

AKUZAT

Kreu I PD-së foli me tone të ashpura për lidhjet e qeverisë me oligarkët, të cilët siç tha ai, pasurohen çdo ditë në kurriz të shqiptarëve dhe udhëtojnë me "Charter" me paratë e qytetarëve. "Oligarkët jetojnë në luks, por edhe Edi Rama bresh me charter në të gjithë botën, ndërsa qytetarët nuk kanë para për një biletë autobus. Ndryshimi po vjen. Shqipëria i ka mundësitë. Ju e keni në dorë çelësin e ndryshimit. Vende pune për çdo shqiptar dhe veçanërisht për rininë. Pengesa e vetme për Shqipërinë, është njëri që ka harrur vendin. Rruga që ne kemi përcaktuar do ta nxjerrë Shqipërinë nga kjo krizë. Të shtunën të mbledhemi në sheshin e protestës, për të kërkuar një qeveri tranzitore dhe të krijojmë një qeveri për popullin. Ne duam që femijet tanë ta ndërtojmë jetën këtu. Shqipëria nuk është një vend i varfër, por është vend i

Spiropali: Vendoret dhe pa opozitën, s'ka zgjedhje të parakohëshme

Për Ministrin e Shtetit për Marrëdhënien me Parlamentin, Elisa Spiropali, parlamenti është legitim. E ftuar në emisionin "Kjo Javë" në nënës 24, Spiropali deklaroi opozita zgjedhje të vetëvritet e të dalë nga fushë beteja. Spiropali tha se zgjedhjet vendore do të mbahen edhe nëse opozita nuk do të marrë pjesë në to.

"Ne besojmë se do regjistrohen se nuk besoj se kanë humbur arsyen deri në këtë pikë. Mendjet racionale brenda opozitës do i bëjnë thirrje këtyre dy forcave të marrin pjesë në zgjedhje. Në të gjitha rastet ne jemi aty do paraqitemi dhe të shohim cilët do paraqiten për t'iu përgjigjur qytetarëve dhe për të ardhur

në garë" -theksoi Spiropali. Ajo u shpreh e vendosur se nuk do të ketë zgjedhje të parakohshme sikundër kërkon opozita. "Zgjedhjet do të mbahen në 2021. Parlamenti do të vazhdojë të funksionojë sepse kushtetuta e detyron shumicën dhe qeverinë të bëjë detyrën"- tha ajo.

vjedhur. Ta vazhdojmë betejën deri në fitore. Që ta vijojmë betejën, na duhet dinjteti, përkushtim dhe qëndresë", theksoi z.Basha. Kreu I PD-së premtoi uljen e taksave, si edhe theksoi se kur ai të vijë në pushtet do të heqë taksën e Rrugës së Kombit. "Ne kemi planin uljen e çmimit të nafës me 30 le, uljen e taksës për biznesin e vogël me 0.5 % xhiro në vit dhe asnjë taksë tjetër as lokale dhe as qëndrore. Do heqim taksën e rrugës së Kombit, patjetër", u shpreh z.Basha.

RIKANDIDIMI

Ende nuk ka një vendim nga opozita për hyrjen në zgjedhjet lokale të qershorit, por kurdo që ato të mbahen duket se kreu i PD, Lulzim Basha, nuk mendon emër

tjetër për Bashkinë e Kamzës veç Xhelal Mziut, i cili është dhe kryebashkiaku aktual i Kamzës. "Edhe njëherë dua të falendoj një njeri që ka mbajtur fjalën para jush dhe para meje me punën e përditshme në këto javë muaj e vite që i besuat mandatin e Bashkisë. Akoma ka shumë halle por jam i sigurt që kur ti bashkojmë forcat pushtetit lokal me Xhelal Mziun dhe pushteti qendror me një qeveri që do ti përgjigjet halleve, ndryshimi pozitiv do të ndihet. Por duhet të fitojmë betejën në 16 mars", deklaroi z.Basha. Kreu i PD-së i ftoi të gjithë në sheshin e protestës, duke deklaruar se do ti japin fund qeverisë së krimit në sheshin e lirisë me datën 16 mars. "Herën e fundit këpuçet u mbushën me pluhur dhe bal-

të por sot rrugët janë ndërtaur i pashtë me sytë e mi, janë ndërtaur të gjithë rrugët lidhëse dhe këtu në këtë qendër historike në Babrru, ku për herë të parë në 30 vite po shikoni çfarë mund të bëj një pushtetar që e jep fjalën dhe e mban fjalën ju tha që do të ju ndërtoj rrugët dhe i ndërtoj. Por ju miqtë e mi e dini edhe anën tjetër të kësaj medalje të pushtetarit që premtim dhe nuk bën asgjë që premtim 300 mijë vende pune dhe çoi 500 mijë refugjatë, premtim shëndetësi falas dhe i shkatërrim spitalet, premtim uljen e taksave dhe sot shumë njerëz kanë mbyllur bizneset nga ata që kam takuar në zonën e Paskuqanit dhe të tjerë po bëhen gati për të mbyllur për shkak të taksave të larta dhe çmimit të energjisë", deklaroi z.Basha.

"Situata e paprecedentë, pragu i një krize financiare"

Nishani: Rama do të eliminojë PD, pas dy muajsh s'ka roga e pensione

Ish-presidenti Bujar Nishani teksa foli rreth protestave të opozitës së bashkuar, ku policia përdori gaz lotsjellës ndaj protestuesve, ai akuzoi se donin të infiltronin individë jashtë policisë. Në studion e emisionit "Kjo Javë", Nishani u shpreh se reagimi i policisë ndaj masës së protestuesve është një akt i rëndë penal. "Unë jam i bindur se do të vijë dita që ai akt do të hetohet. Unë kam qenë ministër i brendshëm në një moment delikat atë të pas zgjedhjeve të 2009. Të gjithë e mbajnë mend protestën që bënte opozita e asaj kohe, pushtet sot, para KQZ. I kemi parasysh si deputetët i hidheshin sipër policisë. Atëherë është diskutuar gjatë dhe është marrë vendimi për tu mos u përdorur gaz lotsjellës. Policia ka një manual për shpërndarjen e gazit, ka forca të trajnuara, që nga elementët me ndikim emocional, të mbrojtja trupore makinat me ujë, izolimi i individëve që udhëheqin turmën. Dhe asnjë prej këtyre s'u respektua, po u shkua te neni i fundit", tha Nishani. Kreu I Këshillit Kombëtar të PD-së Bujar Nishani shprehu shqetësimin se situata e krijuar është e paprecedentë, ndërsa shton se vendi është në pragun e një krize financiare. "Situata është e vështirë dhe e paprecedentë. Nuk është problemi që kreu i maxhorancës ka dashur të e eliminojë opozitë, ai ka 6 vite që energjitë i ka përqëndruar në eliminimin e opozitës, jo në mirëqenien e popullit. Një personazh i rritur dhe i formuar me një sjellje si pas 15 vitesh, që kërkon ta zhbejë opozitën. Opozita ka bërë një zgjedhje të mençur. Opozita duhet ta rrisë presionin e saj ndaj një njeriu. Jemi në pragun e një krize financiare, tregu financiar po shkon drejt një kolapsi. Nëse shqiptarët pas dy muajsh nuk do të marrin dot rrogat e pensionet, do të rritet irritimi", tha z.Nishani. Ai komentoi edhe vendimin e opozitës për dëgjien e mandatëve, për të cilin tha se erdhi si rrjedhojë e një rrugëtimi ku jo vetëm opozita, por në tërësi shoqëria ka hyrë në një neqecje totale. Për të arritur në një vendim të tillë, Nishani tha se ka pasur diskutime të shumta mes politikës, por edhe me qytetarët.

NJOFTIM ANKANDI

1. Shoqëria e Përmarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k njofton Shpalljen e Ankandit të (tërë), për shirjen e pasurisë ULLISHTE , me sip.3.400 m². Zona Kadastrale: 1615 Numri i Pasurisë: 3271, Vol. 1, Faqe 221, ndodhur në Fier-Shegan Lushnje, në pronësi të: z.Bajram Selfer Skraqi , i datëlindjes 14.11.1967, Ankandi i pasurisë fillon me çmimin fillestar në vlerën **1.713.600 (një milion e shtatëqind e trembëdhjetë mijë e qjashtëqind) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **12.03.2019**, ora 16:00, pranë zyrës së Shoqërisë së Përmarimit "BAILIFF SERVICE E.HOXHA" sh.p.k, në adresën Rruga "Vaso Pasha" Pallati 13/1, Ap.1, Tiranë, nr.telefon 042320227, email: elvinth@hotmail.com.

NJOFTIM ANKANDI

Përmaruesi Gjyqësor Privat Neritan Çuko, në datën 20.03.2019 ora 16:00 zhvillon ankandin e Pare, për shitjen e pasurisë së paluajtshme të llojit "Apartament me siperfaqe 65 m², me numer pasurie 410/168/ND+1-19, në volumn 1, faqe 110, hyrja 1, apartamenti 19, në zonën kadastrale nr. 2832, në Orikum ,Vlore, në pronësi të Albert Sali Troqe, me debitor Tonin Troqe. Çmimi fillestar me të cilin fillon ankandi është EUR 23.200 (njzetete e tremje e dyqind euro).

Për çdo informacion mund të kontaktoni: Cel: Neritan Çuko: 0686055334; E-mail: neritancuko@gmail.com.



Rritja e Sigurisë Rrugore, Banka Botërore investon në Qafë Thanë

Balluku: Zgjidhje problemeve në akset rrugore


Në kuadër të Strategjisë Ko mbëtare për Mbrojtjen dhe Sigurinë Rrugore, Autoritetit Rrugor Shqiptar, me mbështetjen e Bankës Botërore, ka nisur punën për të eliminuar pikat e rrezikshme në aksin rrugor të Qafë Thanës. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku ka inspektuar punimet, në njërin prej këtyre pikave, e cila për shkak të rrethimeve të skarpitit ishte kthyer në një rrezik për përdoruesit e rrugës. "Fokusi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe të Autoritetit Rrugor Shqiptar është plotësisht tek Strategjia e Sigurisë Rrugore. Ky është një aks i rrahur me problematikë të shtuar tek i cili në sot po ndërhyjmë, por ashtu siç e kemi thënë dhe në inspektionet e mëparshme fokusi ynë është në sigurinë rrugore dhe ne nuk do të rreshtim pa zgjidhur të gjithë problematikën që sot



Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku

hasim në akset rrugore", u shpreh ministria Balluku. **ARRSH** Ndërkohë, drejtoresha e ARRSH, Sonila Qato bëri të ditur se investimi në fjalë parashikon ndërhyrjen për mbrojtjen dhe përformimin e skarpatës me mure mbajtëse, të lartësisë nga 3 deri në 5 metra, për një gjatësi gati 82 metra linear. "Është vlerësuar nga ana e konsulentëve se duhet të ndërhyhet në mënyrë që të bëhet një investim për mbrojtjen dhe përformimin e kësaj skarpate me mure mbajtëse, të lartësisë nga 3 deri

në 5 metra për një gjatësi gati 82 metra linear. Është një investim i cili do të sigurojë këtë aks shumë të rëndësishëm kombëtar për qarkullimin e mjeteve të zakonshme dhe të mjeteve të rënda sigurinë rrugore për të gjithë drejtuesit por sigurisht edhe për mirëmbajtjen e infrastrukturës rrugore në këtë segment". **INVESTIMET** Në total për vitin 2019 parashikohet eliminimi i 19 pikave të zeza në akse të ndryshme, duke rritur sigurinë në rrugë dhe shmangur aksidentet.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

INSTITUCIONI I PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS

NJOFTIM – SHPALLJE

PËR HAPJEN E PROCEDURAVE TË APLIKIMIT PËR PLOTËSIMIN E "VAKANCËS SË PARAKOZHME" TË KRIJUAR PËR VENDIN GJYQTOR NË GJYKATËN KUSHTETUESE

Presidenti i Republikës, në mbështetje të nenit 93, 125, 127 pikat 1/ç, 2, 3, dhe nenit 179 pika 2 të Kushtetutës, neneve 7 pika 2, 7/a, 7/b, 7/dh pika 2, 86 pika 4 shkronja "c", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe Vendimit nr. 9, datë 24.10.2018 të Kolegjit të Posaqëm të Apelit, njoftuar nga Gjykata Kushtetuese me shkresën nr. 380/4 prot. datë 29.10.2018, me cilësinë e organit të emërtesës, me qëllim plotësimin e "Vakancës së pararakshme", të krijuar në Gjykatën Kushtetuese, dhe me cilësinë e organit të emërtesës me Dekretin nr. 10946, datë 09.11.2018, ka miratuar:

n Shpalljen e procedurës së aplikimit për emërim gjyqtari në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, për plotësimin e "Vakancës së pararakshme" të krijuar nga përfundimi përpara kohe i mandatit, të ish-gjyqtarës Znj. **Altina Xhoxhaj**, sipas vendimit nr. 9, datë 24.10.2018, të Kolegjit të Posaqëm të Apelit.

Presidenti i Republikës fton:

Çdo person të interesuar që plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuara në Kushtetutën e vendit dhe nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, të marrë pjesë në këtë procedurë të konkurrit me hapur publik, për vakancën e mësipërme, për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese dhe të paraqesë pranë Institucionit të Presidentit të Republikës:

- Kërkesën për shprehjen e interesit për të kandiduar për vendin vakant të shpallur;
- Jetëshkrimin, me të dhënat e plota të kontaktit (*numër telefoni/email*);
- Fotokopje të kartës së identitetit;
- Dokumentacionin shoqëruar nëpërmjet të cilit vërtetohet përmbushjen e kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.
- Formularin e vetëdeklarimit të plotësuar dhe nënshkruar sipas përcaktimeve të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike". Formulari i vetëdeklarimit, është i publikuar në faqen kryesore të Institucionit të Presidentit të Republikës.
- Formularin e aplikimit të plotësuar "Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta", në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29, të ligjit nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e Ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë", formular ky i cili është i publikuar në faqen kryesore të institucionit të Presidentit të Republikës.
- Listë të dokumentacionit të dorëzuar, të firmosur nga aplikanti.

Për lehtësinë e të gjithë aplikantëve, me qëllim plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, më poshtë gjëni të botuar përmbajtjen e nenit 125, pika 4 e 5 të Kushtetutës dhe nenit 7/a, të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ku parashikohen kushtet dhe kriteret për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese,

■ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë Neni 125

4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesor ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 viteve të fundit përpara kandidimit. Kriterë të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.

■ Ligji nr.8577, dt 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar. Neni 7/a

Kriteret dhe kushtet e emërimit të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese

1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;
- d) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një veprë penale;
- e) të mos jetë larguar nga detyra për shkak disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- f) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kriterë:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.

3. Plotësimi i kriterëve të mësipërme vlerësohet në bazë të:

- a) vjetërsisë në profesion;
- b) përvojës së veçantë të kandidatit në një fushë të caktuar të së drejtës, ose këshilltar ligjor i Gjykatës Kushtetuese ose Gjykatës së Lartë;
- c) kualifikimeve pasuniversitare dhe trajnimeve në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në një fushë tjetër të së drejtës;
- d) treguesve shkencorë, ku përfshihen botimet dhe artikujt shkencorë në fushën juridike;
- e) ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë juridik, me një mesatare notash jo më pak se 8 ose të barasvlerhme me të, nëse arsimi i lartë është përfunduar jashtë vendit ose vlerësimit përfundimtar në Shkollën e Magjistraturës;
- f) informacioneve të marra nga institucione të tjera publike.

4. Organet e emërtesës marrin parasysh përbërjen e Gjykatës Kushtetuese në momentin e emërimit të kandidatit për të garantuar balancën ndërmjet përvojave profesionale të anëtarëve dhe respektimit e barazisë gjinore.

Kërkesa dhe dokumentat shoqëruese mund të dorëzohen me postë ose drejtpërdrejtë në ambientet e Institucionit të Presidentit të Republikës, në adresën: Institucioni i Presidentit të Republikës, Biv. "Dëshmorët e Kombit", Nr. 1 Tiranë, Kodi Postar 1001.

Afati i paraqitjes së kërkesës me dokumentacionin e nevojshëm, është brenda datës 26 nëntor 2018.

Pas administrimit të dokumentacionit, lista e aplikantëve do të publikohet në faqen zyrtare të internetit të institucionit të Presidentit të Republikës dhe me mjetet e informimit publik, dhe menjëherë dosjet respektive për secilin aplikant do t'i përcillen Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) për vlerësim sipas ligjit.

Institucioni i Presidentit të Republikës, do të bëjë transparente çdo rezultat të këtij procesi në përputhje me Kushtetutën dhe procedurën e parashikuar në nenin 7/b, të ligjit nr.8577/2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Për çdo sqarim mos hezitoni të kontaktoni në këto të dhëna kontakti:
 Numri telefonit: 042369898

"Ndëshkohet" fshati

Mbi 9600 gjoba në një vit, kryesojnë parkimet e gabuara

Mbi 9600 gjoba janë vendosur në periferitë e kryeqytetit gjatë vitit që lamë pas. Nëse deri më tani fokusi për kontrollin e territorit ka qenë kryesisht në zonat urbane, tashmë edhe në ato rurale ka një vëmendje më të shtuar në këtë drejtim. Kështu, sipas të dhënave nga Policia Bashkiake, për njësitë rurale të Tiranës janë vendosur në total plot 9622 gjoba për shkelje të ndryshme. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kryesisht parkimet e gabuara mbajnë rekordin e numrit të gjobave, ku në 2018-ën janë vendosur 8784 të



tilla. Po ashtu një numër i lartë gjobash në rreth 343 janë vendosur për mungesë dokumentacioni, si dhe 272 gjoba për aktivitet pa leje. Më

pas numri i gjobave është në rënie, ku për zënie të hapësirave publike janë vendosur 151 të tilla, për ndotje mjedisi 36 masa administrative, për shpërdorim të ujit të pijshëm 17 gjoba, 15 gjoba janë të formave të ndryshme. Ndërsa numri më i ulët i masave të marra është për prishje të qetësisë publike, në vetëm 4 ndëshkime. Njësitë e ndëshkuara janë Dajti, Farka, Kashari, Petrela.

Kreu i ALUIZNI-t: 80% e pronave të regjistruara, rezultojnë me gabime

Regjistrimi i pronës, Lame: Pronarët që përfitojnë nga amnistia

Falen kamatëvonesat e qytetarëve që nga viti 1994

Të gjithë qytetarët që nuk kanë kryer pagesa ndër vite të kërkuara për regjistrimin e pronave të tyre, do të përfitojnë amnistia. Pronarët do të rregjistrojnë pronën duke paguar vetëm tarifën e rregjistrimit pa asnjë kamatëvonesë. Lajmi është bërë i ditur nga kreu i ALUIZNI-t Artan Lame, i cili bëri të ditur dje se Ligji "Për Kadas-trën" hyn në fuqi më 22 Mars dhe më pas do të nisë procesi i strukturimit të institucionit ligjzbatues, që do të jetë Agjen-cia Shtetërore e Kadastrës. "Shteti që nga viti 1994 ka filluar procesin e rregjistrimit të pronës dhe ka shpenzuar 200 milionë dollarë në procesin e regjistrimit. I gjithë ky lum parash ka lënë pas dhjetëra mijë procese gjyqësore, qindra të vrarë dhe bllokimin e mijëra aktiviteve ekonomike. Qeveria do të marrë të gjithë përgjegjësitë e kësaj situatë. Amnistia për var-gun e pagesave të pa kryera në vite. Ligji i ri nuk do të sjellë lumturim për një ditë, por rrugë tjetër nuk ka" tha Lame. Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, Artan Lame, bëri me dije se 80 për qind e pronave të regjistruara në vend janë me gabime dhe se ligji i ri për kadastrën do ta vërë në shina këtë problematikë. "Presiden-ti miratoi me heshetje ligjin për Kadastrën. Ligji shmang bu-rokracinë, shkryn në një të vetëm disa nga institucionet që merren me pronat. Thelbi është zvarritja 30-vjeçare. 80% e pronave në Shqipëri janë të hedhura me probleme" tha Lame. "Përmes këtij ligji, Qeveria do të do të marrë mbi vete të gjitha përgjegjësitë e kësaj situatë dhe jo të vijojë me përcjelljen e pasojave të mëkateve të veta tek qyteta-rët.



Kreu i ALUIZNI-t, Artan Lame

Ligji për kadastrën, afatet për faljen

Hyrja në fuqi e ligjit të ri për krijimin e Agjencisë Sh-tetërore të Kadastrës do të sjellë edhe një "amnistia" për pronat e paregjistruara në zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në ligjin e mëparshëm parashikohej se nëse një kërkesë për regjistrim paraqitet më vonë se 30 ditë nga data e realizimit të tij, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesë, që ka kaluar nga kjo datë, paguhet kamatëvonesë, e barabartë me 10 për qind të tarifës së regjistrimit, por jo më shumë se 300.000 lekë. Të gjitha kamatëvonesat e gjenëruara nga sistemi i regjistrimit të pasurive të paluajtshme deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, pra deri me 20 mars, do të shu-hen. Nga data 20 mars deri me datën 20 prill ata që kanë veç tarifës së regjistrimit të pasurisë kanë edhe kamatëvonesë, do të mund të bëjnë regjistrimin duke paguar vetëm tarifën e regjistrimit, pasi kamatëvonesa u falet.

FUSHA E VEPRIMIT

- Në këtë ligj përcaktohen rregulla për:
 - a) organizimin e regjimit kadastral të shtetit;
 - b) regjistrimin e pronave të paluajtshme private, shtetërore dhe publike, të të drejtave reale mbi to;
 - c) përmirësimin/përditësimin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
 - c) krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës
- Kërkesa dhe afatet:
 1. Çdo shërbim kadastral kryhet vetëm pas dorëzimit të një kërkesë. Kërkesa është një formular tip që gjendet në sportelet e shërbimit ose on-line. Modeli i kërkesës miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme, sipas llojit të shërbimit që kërkohet.
 2. Agjencia publikon të gjitha llojet e shërbimeve që kryen kadastral, formularin e kërkesës/s përkatëse dhe dokumentacionin shoqërues të kërkuar për çdo shërbim. Publikimi duhet të jetë i dukshëm dhe i arritshëm për çdo shtetas.
 3. Çdo kërkesë për shërbim kadastral, që paraqitet rregullisht, trajtohet brenda 15 ditëve nga data e depozitimit, por në çdo rast jo më vonë se 21 ditë kalendarike.
 4. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për procedurën e trajtimit të kërkesave.
- Regjistrimi i kontratës së shitjes :
 1. Kontrata e shitjes për një pasuri të paluajtshme regjistrohet në seksionin përkatës të kartelës kadastrale, pas verifikimit të elementeve të formës e të përmbajtjes së aktit noterial, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
 2. Shitja e pasurisë së paluajtshme private bëhet vetëm me akt noterial, të hartuar sipas kërkesave të Kodit Civil dhe të legjislacionit për noterinë.
 3. Drejtoria vendore i krijon të gjitha lehtësitë noterit gjatë fazës së hartimit të kontratës së shitjes. Noteri mund të aplikojë për marrjen e informacionit kadastral mbi pronën, objekt shitjeje.
 4. Agjencia bën publike të gjitha kërkesat që duhet të plotësojë pronari ose personi i interesuar për të regjistruar kontratën e shitjes. 5. Kontrata paraprake e shitjes regjistrohet në përputhje me dispozitat e Kodit Civil.

Personat që kanë pronë për të regjistruar dhe kanë shkëlur afatet ligjore mund ta kryejnë regjistrimin deri në 20 prill duke përfituar kështu faljen e kamatëvonesave. Hyrja në fuqi e ligjit të ri për krijimin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës do të sjellë edhe një "amnistia" për pronat e paregjistruara në zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

trës do të sjellë edhe një "am-nistia" për pronat e paregjis-truara në zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Në ligjin e mëparshëm parashikohej se nëse një kërkesë për regjistrim para-qitet më vonë se 30 ditë nga data e realizimit të tij, përveç tarifës së regjistrimit, për çdo ditë vonesë, që ka kaluar nga kjo datë, paguhet ka-matëvonesë, e barabartë me

10 për qind të tarifës së regjistrimit, por jo më shumë se 300.000 lekë. Me ligjin e ri, parashkohet se të gjitha ka-matëvonesat e gjenëruara nga sistemi i regjistrimit të pasur-ive të paluajtshme deri në hyr-jen në fuqi të këtij ligji, pra deri me 20 mars, do të shu-hen. Nga data 20 mars deri me datën 20 prill ata që kanë veç tarifës së regjistrimit të pasur-isë kanë edhe kamatëvonesë, do të mund të bëjnë regjis-trimin duke paguar vetëm tar-ifën e regjistrimit, pasi ka-matëvonesa u falet. Ligji i ri që parashikon shk-irjen e Agjencisë së Legaliz-imeve, Zyrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Agjencisë së Inventariz-imit dhe Transferimit të Pronave Publike është pub-likuar në Pletoren Zyrtare duke i hapur rrugë në këtë mënyrë nisjes së procesin konkret. Ligji i ri parashikon krijimin e Agjencisë Sh-tetërore të Kadastrës. Kjo Agjenci duhet të krijohet jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji, çka nënk-upton se ngritja duhet të bëhet deri në 20 prill.

BËHETIFIKATAT

Sipas ligjit të ri drejtoria vendore, në përfundim të regjistrimit fillestar ose pas regjistrimit të çdo kalimi pronësie nga një pronar te një tjetër, lëshon certifikatën e pronësisë. Certifikata e pronësisë është dokumenti unik i papërsëritshëm që pro- von titullin e pronësisë, sta-tusin ligjor dhe kufijtë e pronës. Sipas ligjit Certifika-ta e pronësisë i lëshohet vetëm personit pronar ose bashkëpronarëve. Në rastin e bashkëpronësisë certifikata hartohet në afat kopje sa është numri i bashkëpronarëve. Ndërkohë që certifikata e pronësisë shoqërohet gjithnjë me kopje të kartelës kada-strale dhe hartës përkatëse kada-strale dhe hartës përkatëse të pronësisë mbi pasurinë, bash- kimi apo ndryshimi të pronë-sisë dhe i certifikatave së përditësuar. Sipas ligjit Cer-tifikata e pronësisë, bash- këpronësisë lëshohet mbi ba-zën e një dokumenti ligjor origjinal që përcakton kr-ijimin e këtyre të drejtave. Një certifikatë e lëshuar në kundërshtim me këtë parash- ikim konsiderohet absolut- ish e pavlefshme. Ndërkohë lëshohet certifikatë dhe për-vetëtimin e të drejtave të tjera reale mbi pasurinë e paluajtshme, si: qiraza, en- fiteoza, përdorimi, uzufruk-ti, servituti, hipoteka etj. Modeli i certifikatave së pronësisë dhe i certifikatave për të drejtat e tjera reale mbi pasurinë miratohet me vendim të Këshillit të Min- istrave. Certifikatat që lëshohen jashtë modelit të miratuar nuk kanë asnjë vlerë ligjore.

SHPALLJE ANKANDI

Zyra Përbarimorë "E.G Bailiff Service" me përbarues gjyqësor Enuar Merka me adresë Rr. Ibrahim Rruova, Pall 64, Hyrja B, Ap 1, Tiranë, njofton se më datë 05.04.2019 ora 8⁰⁰ - 16⁰⁰ në ambientet e saj, do të zhvillohet: Ankandi i II-të për shitjen e pasurisë së paluajtshme, me numër pasurie Nr 5/264/ND+1-2, ZK. 8250, me sipërfaqe 137 m² me adresë Tiranë, në pronësi Z.Bujar Musa Kajtazi me vlerë fillestare në ankand 69.216 (Gjashhtëdhjet e nëntë mijë e dyqind e gjashhtëmbëdhjetë) EURO . Të interesuarit të kontaktojnë në nr. e telefonit +355 4 22 31 888.

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e tretë për pasurinë : 1-"Are", me sipërfaqe 1.200 m², e ndodhur në Katudin i Ri, Tiranë në Zonën Kadastrale: 2119. Numri i Pasurisë: 97/1/1, Vol. 2, Faqe. 19761 në pronësi te Albert Seadin Duka . Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 19.152 (nëntëmbëdhjet mijë e njëqind e pesëdhjet e dy) EURO ose 2.394.000 (dy milion e treqind e nëntëdhjet e e kater mijë) LEKE. Ankandi i tretë për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 01.04.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përbaruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883 .

NJOFTIM SHITJE ME ANKAND

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e parë për pasurinë : 1-"Trull", me sipërfaqe 250 m² dhe sipërfaqe ndërtese 85m², e ndodhur në Bitnicke, Devoli, në Zonën Kadastrale 1202. Numri i Pasurisë: 1831/50, Vol. 20, Faqe. 70. Në pronësi të Vasil Ferit Muceku .Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën 8.000 (tetë mijë euro) EURO ose 1.000.000 (një milion) LEKE. Ankandi i parë për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 15.03.2019 , ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përbaruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri, vila nr.8/1,kt.4,Tiranë, nr.kontakti 0699381883 .



Largohet nga detyra kreu i Policisë Vlorë, emërohet në vend të tij "shefi i përgjimeve"

VLORË - Drejtori i Policisë së Vlorës, Gentjan Shehaj është larguar nga detyra dhe është transferuar në Akademinë e Sigurisë. Në vend të tij është emëruar Artion Duka, i cili ka qenë më herët drejtor i policisë Berat. Gentjan Shehaj, drejtonite blutë e Vlorës që prej prillit të vitit 2017. Ai mban gradën Drejtues i Parë. Artion

Duka ka qenë dhe Drejtor i Forcave Operacionale i përmendur shumë gjatë çështjes së përgjimeve dhe pajisjes misterioze "IMSI CATCHER" që solli debate të shumta dhe në arenën politike. Në qershor të vitit 2016, Duka dhe një specialist tjetër u arrestuan me urdhër të Prokurorisë, pasi akuzoheshin për përgjime të

paligjshme me pajisjen "IMSI CATCHER", por u kthyen në liri shumë shpejt si edhe në detyrat që kishin. Vetëm një vit më parë, në prill të vitit 2018, Artion Duka u emërua në Drejtorinë e Policisë së Qarkut të Beratit. Për emërimin e tij në krye të policisë së Beratit pati reaguar edhe Partia Demokratike. Ish-

deputeti Flamur Noka deklaroi se Duka përdori pajisjen e famshme "IMSI CATCHER" IMSI për të përgjuar gazetarë, politikanë, analistë e ambasadorë. Po kështu mësohet se në Policinë e Shtetit janë kryer lëvizje të tjera, të cilat pritet të zyrtarizohen së shpejti. Lëvizja e radhës është në policinë e Fierit. Drejtori aktual Albert Nushi është larguar dhe në vend të tij është komanduar nëndrejtori i policisë Fier, Andon Marko. Ndërsa, Nushi është komanduar nëndrejtor në policinë e Elbasanit.

35-vjeçari ishte shpallur në kërkim në kuadër të operacionit të koduar "OAZ"

Pjesë e grupit kriminal "Bajri", arrestohet boksieri i "Vlaznisë"

Nelson Hysa u kap në një apartament me qira në Tiranë

TIRANË

Një tjetër anëtar i grupit kriminal "Bajri", i cili ishte shpallur në kërkim që nga shtatori i vitit të kaluar ka përfunduar në prangat e policisë. Bëhet fjalë për boksierin e ekipit të "Vlaznisë", Nelson Hysa. 35-vjeçari nga Shkodra u arrestua mëngjesin e djeshëm, në një apartament të marrë me qira në Tiranë. "Në vijim të operacionit "OAZ", në funksion të procedimit penal nisur gjatë vitit 2018, në kuadër të Operacionit "Forca e Lëvizit", si pjesë e grupit kriminal "Bajri" me aktivitet të shtuar kriminal në Shkodër, mëngjesin e sotëm u bë ekzekutimi i vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, e cila ka caktuar masën e sigurisë "Arrest me



I arrestuari, Nelson Hysa

Burg" për shtetasin Nelson Hysa, 35 vjeç, lindur dhe banues në Shkodër", njoftoi policia. I riu ishte person i shpallur në kërkim që prej shtatorit 2018, gjatë operacionit "OAZ", si i dyshuar për kryerjen e veprave penale: "Organizata

kriminale, "Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale" dhe "Grupi i strukturuar kriminal", "Paracaktimi i rezultateve në garat sportive, e kryer në bashkëpunim", për qëllime të fitimit pasuror. Sipas bluve, Nelson Hysa u pra-

nos në një banesë të marrë me qira në zonën e "Komunës së Parisit" Tiranë, gjatë operacionit të zhvilluar mëngjesin e djeshëm nga Njësia Hetimore Qendrore në bashkëpunim me Drejtorinë e Forcës Posaçme Operacionale, në Departamentin e Policisë Kriminale dhe Prokurorinë e Krimeve të Rënda. "Njësia Hetimore Qendrore për të lokalizuar vendndodhjen e personit të shpallur në kërkim ka bashkëpunuar me Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë dhe Shkodër. Gjatë veprimeve proceduriale u sekuestrua një automjet "BMË Seria 3". Materialet proceduriale shtesë iu referuan Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë.



Ndahet papritur nga jeta Zv. Drejtori i SHÇBA-së

TIRANË - Ndahe papritur nga jeta Zv. Drejtori i Përgjithshëm i Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, Agim Hysi. Lajmin e ka bërë publik vetë SHÇBA në faqen zyrtare në "Facebook", ku shkruan se Hysi është ndarë nga jeta në moshën 61-vjeçare pas një ataku kardiak. Hysi ka mbajtur postin e Zv. Drejtorit të SHÇBA prej vitit 2017. Ai ka pasur një karrierë të gjatë e të spikatur në jurisprudence, si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjyrokastër si edhe avokat. Në vitin 2016, Hysi ka qenë i angazhuar si ekspert për vlerësimin e legjislacionit në kuadrin e Reformës në Drejtësi, ndërsa në vitin 2017 është angazhuar si ekspert për vlerësimin e ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale dhe Kodin e Procedurës Civile-Komiteti Helsinki.

SHKURT

14-vjeçari vret me armë vëllain, ngjarja dyshohet të jetë aksidentale

PEQIN - Një 21-vjeçar ka mbetur mbrëmë i vranë me armë gjahu në fshatin Galush të Peqinit. Mësohet se viktimja është 21-vjeçari Roland Lleshi. Burime nga policia lokale bënë me dije se ka qenë 14-vjeçari, Kristian Lleshi që ka vranë aksidentalisht me armë çifte vëllain e madh. Pas sinjalizimit, policia ka shkruar menjëherë në vendngjarje dhe ka nisur hetimet për zbardhjen e plotë të rrethanave të vrasjes së të riut. Nga kryerja e veprimeve paraprake hetimore, dyshohet se ngjarja ka ndodhur aksidentalisht.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbim konsulence në fushën e redaktimit (proofreading) në gjuhën angleze për përcjelljen në publik të informacionit të BSH për vitin 2019".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Ftesë për kuotim kombëtare", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limitit 472,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim.

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 18 Mars 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Realizimi i lidhjes online ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare".

Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limitit 9,720,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Realizimi i lidhjes online ndërmjet godinave të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë tre vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më **datë 01 Prill 2019, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

BOTIMI

DOM SHTJEFËN KURTI

Kur përndiqej e raportohej nga "Shigjeta", "Shëndeti" dhe "Drita"

Është promovuar dje në Tiranë libri "I lumi Dom Shtjefen Kurti - dëshmitar i kishës martire". Monografia në vëllimin e saj të parë ka autorë Nikollë Lokën dhe Nikolin Kurtin dhe parathënie të Mons. George Frendo Kreu i Konferencës Arqipeshkvnore të Shqipërisë. Ai është botim special i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunistit. Ai lindi në Ferizaj të Kosovës, më 25 dhjetor të vitit 1898. U shugurua meshtar në Romë më 13 maj 1921. Erdhi në Shqipëri më 6 janar 1930, bashkë me Dom Luigj Gashin e Dom Gjon Bisakun dhe u arrestua në Tiranë më 28 tetor 1946 për t'u dënuar me njëzet vjet burg. Bëri vetëm 17 në burgun e Burrelit dhe pas mbylljes së kishave u dërgua në Gurëz (Milot). E arrestuan prapë më 11 qershor 1970 dhe u dënua me vdekje 'in odium fidei'. U pushkatua më 20 tetor 1971.


MARTIRI

Martiri Dom Shtjefen Kurti paraqitet si luftëtar i madh i lirisë fetare dhe politike dhe i ndryshimeve politike pa dhunë. Për vite me rradhë familja e tij nuk pati më asnjë lajm derisa njëra prej motrave, e mbetur në Kosovë, arriti të merrte vesh se ai ishte ende gjallë nëpërmjet një Ispeshkëvi, i cili e kishte lexuar në një gazetë. Në fakt, pak më vonë, e motra në Shkup mori një letër nga Don Shtjefeni, të postuar nga Burreli, ku i kërkonte vitaminat dhe ilaçet.

Edhe në burgun e Burrelit, organet e Sigurimit të Shtetit e kishin në shënjestër. Shpesh e izolonin në birucat e akullta të burgut, ku kalonte netë të tëra, sepse në burg kryente vepra të mira, duke thënë meshtë. Dr. Lazer Rudi kujton: "... Një herë, natën e Krishtlindjeve, me dritë të errësuar si zakonisht Don Shtjefni tha meshtë në mesnatë. Mbas meshe, me ndezjen e dritave shohim dyshemenë e lagur nga lotët e tij...". Edhe Mark Shantaja sjell të dhëna me interes: "Në takim me një murgeshë që i erdhi i kërkoj këtë gjë: Më dërgo at barin me emrin "Vinum Missa". E përsërit edhe njëherë pasi ajo nuk kujtohet se ky lyp venë, për të çue meshtë. Atëherë ja sjellin me një shishe aranzhate me etiketë gjoja si medikament.

Për arsye të një amnistie, me 2 maj 1963 Shtjefen Kurti lirohet nga burgun e Burrelit, pasi kishte bërë 16 vjet, 6 muaj e 2 ditë burg. Po atë ditë në Shkup u bë festë e madhe, pasi në adresë të së motrës kishte arritur një telegram vetëm me dy fjalë, me firmën e Don Shtjefnit: "Jam i lirë". Pas 17 viteve privim lirie, një ditë të ftohtë nëntori të vitit 1963, largohet nga qelqitë e bur-

Botohet monografia për jetën e meshtarit, 16 vitet në burg dhe puna në kooperativë



Dom Shtjefen Kurti



gut, për t'u ndërjerë përkohësisht i lirë. Bëri jetë private, fillimisht te i vëllai Kel Kurti në Gurëz. Sipas bashkëpunorit me pseudonimin "Adresa", ishte detyruar të largohet nga familja e vëllait, sepse ai fliste kundër pushtetit dhe shprehte e tij e dëmtonin shumë priftin.

Pas largimit nga i vëllai është strehuar te zyrat e kooperativës, pastaj për një vit e më shumë te shtëpia e Tomë Nokë Lekës dhe kohë e fundit në shtëpinë e Shkurt Markut pako me veshje gjatë periudhës që ishte në burg dhe po vazh-

Për arsye të një amnistie, me 2 maj 1963 Shtjefen Kurti lirohet nga burgun e Burrelit, pasi kishte bërë 16 vjet, 6 muaj e 2 ditë burg. Po atë ditë në Shkup u bë festë e madhe, pasi në adresë të së motrës kishte arritur një telegram vetëm me dy fjalë, me firmën e Don Shtjefnit: "Jam i lirë". Pas 17 viteve privim lirie, një ditë të ftohtë nëntori të vitit 1963, largohet nga qelqitë e burgut, për t'u ndërjerë përkohësisht i lirë.

donte ta ndihmonte. Ishte i sëmurë nga stomaku, po kërkonte t'i shkruante të motrës që t'ia dërgonte

Dënimi me pushkatim pas liritimit dhe akuzat qesharake që e çuan drejt vdekje

Martiri Dom Shtjefen Kurti paraqitet si luftëtar i madh i lirisë fetare dhe politike dhe i ndryshimeve politike pa dhunë. Për vite me rradhë familja e tij nuk pati më asnjë lajm derisa njëra prej motrave, e mbetur në Kosovë, arriti të merrte vesh se ai ishte ende gjallë nëpërmjet një Ispeshkëvi.

ilaçet prej andej". Për Kurtin kishin dhënë informata dhe bashkëpunorët "Shigjeta", "Shëndeti" dhe "Drita" dhe pas shqyrtimit të informacioneve të mbledhura ishte arritur në përfundimin se kleriku në fjalë po zhvillonte agitacion e propagandë kundër pushtetit popullor dhe prandaj Puntori Operativ Qemal Karamani kishte vendosur ta merrte në përpunim A2. U shtua dhe numri i bashkëpunorëve që do ta survejonin, provokonin dhe do të përcillnin përgjigjet e Kurtit tek organet e Sigurimit të Shtetit. Krahas atyre që kemi përmendur përherë edhe "Partizani", "Patogu", "Drita", "Mati", "Guri", "Guximtari", "Vermoshi", "Misri i kuq", "Kthesa", "Specia", "Tomorri", të cilët e përcollën në çdo hap, në përpjekje për të gjetur ndonjë kleçkë për të formuluar akuzë politike dhe meqenëse dështuan, akuzat e dytë ishin qesharake, duke e akuzuar klerikun me akuzat ordinere.

RRËFIMET NGA FSHATI

...Fshatarët e Gurëzit shihnin te don Shtjefni njeriun e drejtë, njeriun e Zotit, që u falte besim dhe dashuri, u ngrohte zemrat me fjalë dhe i orientonte drejt së vërtetës. Kur në vitin 1967, për shkak të "Revolucionit Kulturor" shqiptar, kishat u mbyllën e si pasojë nuk mund të ushtrohej kulti, Don Shtjefni u dësh të gjente punë si punëtor në kooperativën e Gurizit. Por ndërkohë vazhonte apostullimin e tij në ditët e pushimeve, ose sapo t'i jepeje mundësia, udhëtonte për të administruar sakra-

mentet dhe për të ngushëlluar njerëzit e orientuar. Megjithatë në moshë të thyer, 70 vjeç, që një shembull i shkëlqyer në punë dhe në jetë. Njerëzit i besonin dhe shihnin tek ai njeriun e shpresës. Dhe ai, si engjëll, reflektonte dashuri për të gjithë, por edhe urrejtje për sistemin totalitar që po u imponohej gjithnjë e më tepër shqiptarëve.

Prokurori Llambi Gegeni, me 11 qershor 1970, me argumentin se qënja e tij e lirë mund të sjellë shmangien para organeve të hetuesisë dhe gjyqit, kishte lëshuar fletë-arrestin për Don Shtjefen Kurtin. Më 11 qershor të vitit 1970, kur ai punonte në mes të vapës në arat e kooperativës arrestohet në prani të shumë fshatarëve dhe dërgohet në qelqitë e ftohta të burgut të Krujës, ku pas kontrollit personal, i janë gjetur këto sende: Portofol meshini i thjeshtë, letërnjoftimi personal, 80, 20 (të të dhjetë lekë e njëzet qindarka), një palë teshje me kryq, një shami duarsh, një rryp pantallon meshini, një dëftesë poste për një letër të dheuar në Jugosllavi. Po atë ditë, hetuesi merr një vendim për zhvillimin e kontrollit në banesë, pasi sipas tij nga materialet që disponon Hetuesia, dyshohet se në banesën e Shtjefen Kurtit, të ketë materiale të fshehura, që kanë përmbajtje kundërrivolucionare. Me qëllim që të shtinte në dorë ato materiale që kishin vlerën e provës për fajësinë e Shtjefen Kurtit, konformë nenit 171 të Kodit të Procedurës Penale ishte bërë kontrolli i banesës.

Në procesverbalin e mbajtur gjatë kontrollit të banesës që ishte bërë po atë ditë, me 11 qershor 1970, nga ana e hetuesit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me pjesëmarrjen e antares së Këshillit Popullor të katundit shoqe... (nuk e ka emrin të shënuar) janë shënuar sendet personale të priftit të arrestuar. Gjatë kontrollit u gjetën dhe u morën sendet e poshtëshënuara:

Lekë 1300 (njëmijë e treqind).

Një autorizim i Lekë Nojës për 1000 lekë.

Disa letra dhe dokumente të ndryshme.

Dy blloqe shënimesh, njëri kalendar i vitit 1970.

Gjatë kontrollit të banesës nuk pati ndonjë ankesë nga ana e të arrestuarit. Procesverbal mbasi u lejua nënshkrimi nga të pranishmit, u firmos: Hetuesi, I arrestuari Asistuesi, Antarja e Këshillit. U pushkatua një vit më vonë.

Publikohet në Fletoren Zyrtare lista me personat që u është njohur e drejta për kompensim

Agencia e Trajtit të Pronave publikon listën e 611 pronarëve të njohur për kompensimin e pronës në vitet 1993-2013, të cilëve u është njohur e drejta e kompensimit dhe është kryer vlerësimi financiar. "Gazeta Shqiptare" publikon listën me përfituesit në të gjithë vendin si dhe vlerën financiare për secilën dosje. Lista është botuar në Fletoren Zyrtare dhe bëhet fjalë për dosje të cilave Agjencia e Trajtit të Pronave ka dhënë një vendim. Ndërkohë në 23 shkurt ATP ndërpreu procesin e vlerësimit të dosjeve dhe pronarët që nuk janë njohur me vendimin duhet t'i drejtohen gjykatës.

KOMPENSIMI FINANCIAR DHE FIZIK
Sipas formularëve-tip, mësohet se kërkuesi duhet të

Dosjet 1993-2013, lista me 611 pronarët që marrin paratë

Përfituesit në të gjithë vendin, ja si do të paguhen

cilësorë faktin se kërkon kompensim financiar. Për plotësimin e dosjes duhet të paraqitet kërkesa për kompensim financiar/fizik, konfirmim nga ZVRPP-ja për gjendjen juridike të pronës, vërtetim nga gjykata nëse vendimi përfundimtar i vlerësimit të tij është ankuar apo jo në rrugë gjyqësore, dëshmi trashëgimie nëse ka ndry-

shuar rrethi i trashëgimitarëve, prokurë e nënshkruar nga të gjithë trashëgimtarët, vërtetim numër llogarie, vërtetim nëse subjekti ka përfituar ose jo tokë bujqësore, dokument identifikimi dhe mandat pagese. Të njëjtat dokumente duhet të paraqiten edhe në rastin kur pronari kërkon kompensim fizik.

LLOGARITJA

Kompensimi për ish-pronarët për tokën truall, sipas zërit kadastral të vitit 1945 dhe hartës së vlerës së tokës që është në fuqi do të kryhet me para. Kufiri i caktuar nga ligji është 50 milionë lekë për çdo vendim të njohur. Këshilli i Ministrave ka rregulluar me anë të një vendimi kufirin e pagesës në lekë dhe atë të

kthimit fizikisht të pronës. Kështu, të gjitha vendimet përfundimtare, të vlerësuara financiarisht si tokë truall përfitojnë kompensim financiar nga fondi financiar i kompensimit, deri në masën 50 milionë lekë sipas shkronjës "a", të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr.133/2015, dhe pjesa e mbetur nga vlerësimi i vendimit përfundimtar kompen-

sohet fizikisht, nga fondi i tokës. Neni 8 pika a e ligjit nr. 133/2015 për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave thotë se subjektet e shpronësuara të kompensimit, sipas përcaktimeve të këtij ligji, bazuar në vendimet përfundimtare për njohje dhe kompensim financiar.

LISTA ME 611 PRONARËT QË MARRIN PARATË

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Tiranë	FATIME HALEBI		59.8
Elbasan	ZERIHAT E SELAUDIN KAMBO	110	140
Gjirokastrë	Niko Prase	1414	276
Tiranë	Viril Llagami	255	1629
TIRANË	DUJAK LLAGAMI	668	1612
Berat	MYRTEZA NUELARI	3130	25840
Fier	Shaban Bali		6470
Fier	Marko Sile		2200
Fier	Uan Mehilli		6700
Shkodër	Familja Mema	2073	0
Durrës	Ibrahim Cela	4010	790
Shkodër	Nuri Mreca	201	615
Shkodër	Xhelal Kali	94	2906
Shkodër	Berhan Rrjollli	7945	175
Korçë	Agathoniqi Rusi	60	332.5
Kukës	Syl Selimaj		0
Shkodër	Vehbi Hasan Hoti	1353	173
Korçë		483	707
Tiranë		2462	12042
Tiranë	BAJRAM KARAJ	2434	7750
Tiranë			10340
Tiranë	KADRI GJIK	2682.5	3725.5
Korçë		986	3259
Korçë		2598	1584
Durrës			1000
Gjirokastrë	Petro Kosta	1700	300
Dibër	Beqir Tola		792
Dibër	Selim Hoxha		2016
Fier	Tajar Hoxha		3100
Vlorë	Teli Gjikopuli	3190	1410
Vlorë	Dhimitër Kreko	687	1585
Tiranë	Adem Oktisi, Irfan Oktisi, Ismet Oktisi, Mëkbul Oktisi, Nailo Oktisi		10000
Tiranë	DIZI, TEUTA, LUAN GJUZI	5000	6700
Fier	Fatmir Sabriu	3392	1602
Fier	Eqerem Koxhaj	2625	4650
Tiranë	SHABAN GJOCI	27	1425
Tiranë	SADETE JUKA	487.5	0
Fier	Hava Avdiaj		10900
Lezhë	Ndue Llesh Frroku		10632
Vlorë	Thoma Çollaku	2550	560
Vlorë	Ndreko Kaci	240	600

Qarku	Emri Mbiemri (subjekti kërkuar)	Sipërfaqe e kthyer	Sipërfaqe e kompensuar
Tiranë	KATERINA MIHALI	1432	3651
Tiranë	RIZA XIBRI	5000	18220
Fier	Shyqyrie Psatha		3010
Fier	Luan Licka	5000	10500
Durrës			2383
Vlorë	Perlat Lushaj		2750
Shkodër	Kole Filip Kovaçaj	3975	0
Vlorë	Lono Qiriaçi		0
Tiranë	MUHARREM GUDALLA	270	0
Vlorë	Luan Cakëri	1283	7117
Dibër	Ramiz Kasmi		2400
Shkodër	Simon Lano Hila		650
Shkodër	Pjeter Ndoci Marku	2850	0
Tiranë	LIRI TASHKO	1528	407
Tiranë	FADIL XHAFI	3970	0
Tiranë	SEVIM PESHKEPIA		305
Korçë		1821	2038
Tiranë	TEFTA KERENXHI	84	209.6
Shkodër	Leke Fran Preka		0
Fier	Myftar Buzi		2100
Shkodër	Rrok Kol Marashi		0
Korçë	Xhaferr		625
Korçë	Vangjel Marko	768.5	1144.5
Gjirokastrë	Lili Andon		750
Vlorë	Dhionis Çili	635.4	2893.6
Vlorë	Brahim Tafili	250	550
Vlorë	Bajram Nuhaj, Dile Nuhaj		618
Vlorë	Pandeli Janina	140	1339
Fier	Andrea Papaj	3483	37517
Korçë	Gezim Kondo		1014
Korçë		806	7798
Tiranë	FERID KAZANI	2632	1193
Tiranë	SALI NJAZI DEDE		0
Tiranë	SALI NJAZI DEDE		0
Tiranë	SALI NJAZI DEDE		0
Vlorë	Mysthak Idrizaj, Gëzim Jazaj	16301	974
Vlorë	Mehmet Pashaj		1586
Elbasan	YMER BALLABANI		4830
Elbasan	HASAN LLAHA		1679
Elbasan	ISMAIL ZENUNI		4200
Elbasan	ISLAM KRYEMADHI		3000

Elbasan	JASHAR BALLIU		1929	Vlorë	Cjino Xuxi	864	300
Elbasan	MEHMET MECE		1008	Vlorë	Koço Savo		0
Elbasan	AGIM MECE		1150	Shkodër	Trashegimtare Jaku		0
Elbasan	SKENDER MAMA		1028	Shkodër	Trashegimtare Shabaj		2550
Elbasan	LIVAN DERVISHI		1100	Elbasan	HEKURAN ARIF KRYEZIU		0
Gjirokastrë	Klanthi Nace	373	327	Elbasan	SHEFQET SULEJMAN NEZHA		7175
Korçë	Gjerdan Llabanari	664	1101	Elbasan	SHEFQET SHABAN KARAMUCA		1380
Tiranë	ALI EMIRI	223.5	427.5	Korçë		840	229
Tiranë	ALI EMIRI	223.5	427.5	Korçë	Petraç Demiri		881
Dibër			593	Vlorë	Pëtrit Çakëri	6680	3320
Dibër	Shaban Krusa		1222	Fier	Miti Yloni	1400	4100
Dibër	JASHAR BEXHET BAJRAMI		1740	Dibër	Shefqet Doka		390
Durrës			3872	Korçë	Sefi Goce	7950	300
Lezhë	Xhemal Baftjar Koleci		0	Tiranë	MYSLYM KURDARI		0
Kukës	Basri Shani Elezi		0	Tiranë	FATIME BEJKO	143.8	656.2
Elbasan	HASAN ST AFA		4000	Tiranë	Selim Lundra	2590	0
Elbasan	GANI OMERI		4343	Tiranë	TRASHKIMTARET TRASHKIMTARET	158.5	75.51
Korçë		7858	2724	Tiranë	MURAT LUGA		0
Korçë		800	225	Tiranë		4312	3688
Fier	Beqir Xhindole	200	10800	Tiranë	VASILIKA PETRELA	47135	53294
Fier	Hekuran Musai		7200	Tiranë	VASILIKA PETRELA	47135	53294
Fier	Ilia Shyti		6000	Tiranë		5000	0
Fier	Anerit Taka		5000	Vlorë			600
Korçë			1150	Durrës	ISMAHIL ELIASANI, ISMAHIL ELIASANI, Zeqal Elbasani	1707	1300
Korçë			1785	Durrës	Tofik Goci	1060	1040
Vlorë	Vito Durinja		9	Gjirokastrë	Qendro Cobi	2280	300
Tiranë	Bardhyl Hysi	604	196	Fier	Agim Xhuti		255
Fier	Neshet Zemblaku	1200	1800	Tiranë	QAZIM MALOKU	400	25
Elbasan	BEQIR AGOLLI		2000	Tiranë	ANDI, XHEVDET SHPAKU SHPAKU	1306.5	1049
Elbasan	JEMIN CEKREZI	970	8212	Tiranë	KAPLLAN PEQINI	5000	2000
Fier	Neshet Zemblaku	1200	1800	Tiranë	MITHAT QYQJA	1768	2232
Korçë	Murat Hoxha	5415	230	Tiranë	SABRI LLAGAMI	7003.5	3676
Korçë	Qani Gllavina		5160	Tiranë	MUST AFA MENERI		0
Korçë	Avdyll Cenolli	2825	1176	Tiranë	IBRAHIM TURKU		65
Tiranë	FILIP, ELISABETA GURAZIU	595.4	253	Tiranë	BENIAMIN BAKALLI		0
Dibër	Sadik Patlli	8600	1800	Tiranë	TRASHKIMTARET TRASHKIMTARET		0
Dibër	SELAUDIN DUKA	934	72	Tiranë	ISMAIL FAGU		0
Korçë		745	1234	Tiranë	RIZA XIBRI	14267	7432
Korçë			0	Elbasan	T AJAR PASMAQI	4420	2300
Korçë		3040	620	Elbasan	SHAQIR CELA		700
Korçë	Elmaz Dule		3850	Elbasan	SPIRO GEGA		2400
Korçë	PETRI TOMORRI		151.4	Korçë	Vexhije Musa	77	490
Tiranë	XHELAL, MURAT, SHEFQET MEL SHANI ETI		2000	Tiranë	Sherif Hoxha		1000
Tiranë	IBRAHIM MASHA	1598	652	Elbasan	LA DIJE KABURJA	773	1752
Fier		3860	5300	Elbasan	PASHO KARIQI		6572
Korçë			900	Fier	Halit Hoxha		1250
Vlorë	Xhemil hamzaj	700	1200	Fier	Hysni Mejdani		5000
Korçë		7858	2724	Fier	Llambro Pandi		11500
Korçë		1290	1802	Vlorë	Rakip Haderi	2025	1380
Vlorë	Qamil Hoxha		2000	Fier	Ndoni Sila		4600
Shkodër	Figjret Kazazi		0	Korçë	Gurije Pelivani		1050
Elbasan	HASAN HASA	360	460	Korçë	Qamil Lamçe		740
Tiranë	Nazim Misiri	2761	8127	Korçë	Barije Hysollari	300	250
				Korçë	Musa Rika		4120
				Korçë	Bajram Hoxha		97.7
				Korçë	Halil Sulo		5100
				Korçë	Xhelal Hysenaj		1466
				Korçë	FERID LIMKA		2884
Gjirokastrë	Vaide Zoto		1630	Vlorë	Taibe Manja	4294	788
Gjirokastrë	Luan Xhano	1886	1300	Elbasan	Zane Beqiri		4000
Gjirokastrë	Mitat Dosti	1050	2386	Korçë	NIKO SHALLO	50	2868.6
Elbasan	MYRTEZA LATIFI	2240	1785	Korçë	Muharrem Blacëri	2638	0
Elbasan	HYSEN BROSHKA		714	Berat	Thoma Haxhistasa		1000
Kukës	Azem Sadik Breçani		9980	Korçë	Josif Thoma Kallço	885	62
Tiranë			2500	Korçë	Efigjeni Eski	440	106
Vlorë	Vasillaq Hako	300	1265	Korçë	Jorgji Adhami	1133	0
Vlorë	Luftar Halili	480	480	Korçë	Ferit Zerba	700	1650
Vlorë	Ramadan Veliko	536	150	Korçë	Artur Lipo		7000

Zëri kadastral i originës

Vlorë	Ziso Xhollo	1050	2724
Vlorë	Selamet Xhindi	3640	5000
Vlorë		36128	2387

Fier	Memini Bali		3540
Fier	Kolopi Pambuku		5380
Fier	Shaban Guri		10040
Fier	Veiz Hajdari		10115
Fier	Avni Balla		4800
Fier	Estref Xheka		10500
Korçë		1435	815
Tiranë	BESIM VATHI	7340	3264
Korçë	Besnik Lamçe	4217	970
Dibër	HAJRULLA DISHANI	2580	1360
Fier	Bajram Hysenaj		420
Vlorë	Mustafa Feimi		150
Vlorë	Nevzat Seferi	674	398
Korçë	Xhevit Kasëm Kello		300
Gjirokastrë	Rushit Kopelli	930	400
Korçë	Hysnie Mero		235.19
Elbasan	HALIT KOKONOZI	1342	6578
Fier	Nuri Ymeraj		8550
Fier	Ajet Coku	8000	2400
Fier	Zoi Ndoni	2400	4000
Fier	Ihmi Kurti		9000
Fier	Rrapush Caka		4400
Tiranë	Ramazan Maçi	4892.2	2327.8
Korçë	Thoma Papallia	603	176
Korçë	Ismail Xhiballi		2300
Korçë	Skender Gozhdari		3242
Korçë	Feridon Shpata		666
Korçë	Inajet Xhuti		2103
Shkodër	Fatmir, Valentin Dizdari		1900
Durrës		3800	7885
Korçë			880
Lezhë	Adile Mlika		92
Durrës	Meleq Kalamishi		5000
Durrës	Nikolla Mihal Shani		1150
Korçë	Mijal Gjoka	257	102
Korçë	Stefano Shegani	1026	422
Korçë		340	180
Korçë	Petro Gjoka	112	152
Korçë	Themistokli Kratellari	164	150
Korçë	Trajçe Klime Kratellari	122	30
Kukës	Gani Palushi		1103
Shkodër	Trashëgimataret Simoni		1000
Vlorë	Musa Xhelili		110
Vlorë	Xhezmi Hoxha		200
Vlorë	Efigjeni Avrami		960
Vlorë	Gori Dumani	1366	3534
Korçë	Vançi Bicja	566	150
Korçë	Hysni Avdi Ceno	4125.5	4314.5
Vlorë	Jorgo Anagrosti	1238	1550
Fier	Ali Shehu	728	6272
Gjirokastrë	Qeribe Gjyli	460	300
Elbasan	SERVET KOÇIA		1080
Elbasan	AQIF TOCILA		10350
Elbasan	Teki Shurdha		4603
Fier	Veli Korreshi		4260
Korçë	Ylli Korkuti	1320	467
Gjirokastrë	Muharem Duro		3525
Tiranë		290	227
Durrës	Hajdar Xhumra		4900
Durrës	Nazmi Rexha		0
Durrës	SULLTANE DOMI (GORJA)	8800	1200
Korçë	Kujtim Zhuleku	120	160
Korçë	Shefqet Daiu	192	1808
Vlorë	Aristidh Zoto	181	703
Elbasan	Seit Alushi		5800
Elbasan	RUZHDIE BOCI	143	1839
Gjirokastrë	Bexhet Xhemali		150
Korçë	Trash. Spaho	890	794
Korçë	Gezim Belli		560

Gjirokastrë	Astrit Zeko	792	1515
Tiranë		437	417
Gjirokastrë			147200
Fier	Shaban Xhafa	3195	4600
Korçë	Bardhyl Latifi	969	995.5
Korçë	Gëzim Jaçe, Resmije Etem Jaçe		2398
Korçë	Skënder Kajmaku	1092.5	352
Korçë	Drita Tare, Kujtim Tare		2203
Korçë	Hekuran Luli Leka	777	752
Elbasan	Xhevit Alliu		11740
Shkodër	Myzejen Bushati	2320	720
Shkodër	Shefik Shaqir Meta	550	770
Shkodër	Eljaz Pataloku	1249	12.5
Elbasan	Hysen Karriqi		10477
Korçë	Xheko Agolli	2532	3971
Korçë	Memedie Hyska	675	825
Korçë	Demirali Riza Mino	495	225
Vlorë	Fatosh Fejzo		170
Vlorë	Llukë Çarçani		192
Vlorë	Qemal Harizaj	6362	18488
Vlorë	Bani Petro	112	362
Vlorë	Elmaz Sadiku		5000
Vlorë	varvara Dano, Faciullaha Hoxha	320	715
Korçë	Kamber Sadiku	300	105
Korçë	Ligor Ilia Martini	715.5	422
Korçë		506	902
Shkodër	Tahir Lan Sadiku		0
Durrës	Abdyl Sana	35	105
Korçë	Faik Rustem Spaho		1500
Korçë	Florenc Gruçka	353	1589
Korçë	Qani Fehim	500	300
Fier	Jashar Xhafa	630	3160
Fier	Arif Xhafa		4426
Fier	Ramazan Cala		600
Fier	Sybe Cala		600
Korçë	Feti Agolli	757	93
Korçë	Elmas Hoxhalli		460
Korçë	Bektash Hoxhallari	1265	3653
Korçë	Pandi Foto		1100
Korçë	Theodhoraq Nace	42.3	167.7
Tiranë	Islam Mema		7200
Tiranë	Sabije Meca	294	315
Fier	Arshi Zaçe	3312	7762
Durrës		1413	11100
Korçë	Lefter Shaholli		550
Korçë	Asllan Cake	2490	1027
Elbasan	VASIL MEMA	501	800
Elbasan	FATIME KOFSHA	4960	12552
Elbasan	Refat Duzha		5150
Elbasan	NEFAIL DERMYSHI	1900	28175
Elbasan	BUJAR MIRAKA		2455
Elbasan	GYHERE NASUFI		3202
Korçë	Ilia Dogramaja	1123.2	76.8
Shkodër	Trashëgimataret Neziri	7500	1500
Shkodër	Mhill Mark Geshtenja		2500
Shkodër	Dod Vasa		1100
Shkodër	Trashëgimataret Kola		1300
Durrës	Marika Nika		137
Korçë	Njazi Ibo	300	530
Korçë	Nazar Mançellari	61	444
Durrës	Ramazan Veli		0
Durrës			0
Durrës	Nebi Sefa	630	270
Korçë	Nafije Spaho		500
Korçë	Mynyre Topalli		400
Korçë	Lytifi Mulliri	580	500
Korçë	Theodhor Prodani, Viktor Prodani	575	364.5
Vlorë	Vangjel Janka	170	830

E DIEL

10 Mars

2019

MILOSA O



NGA KOSTANDIN RISTANI

Një fjalë e urtë angleze thotë që "knowing the problem is half of the solution" e cila do të thotë që "njohja e problemit është gjysma e zgjidhjes". Duke u nisur nga kjo fjalë shumë e urtë ky cikël analize shkrimesh është hartuar mbi tri linja kryesore: 1) Përshkrimi i disa nga funksioneve më kryesore të një shteti modern dhe ligjor; 2) Përshkrimi i gjendjes së deritanishëm e nxjerrja në pah e mangësive e boshllëqeve të disa nga funksioneve më kryesore të shtetit shqiptar të krahasuara me funksionet respektive të shtetit modern e ligjor; 3) Propozime mbi objektivat strategjike së bashku me rrugët e mundshme për fshirjen e boshllëqeve, plotësimin e mangësive dhe transformimin e shtetit shqiptar nga gjendja e tanishme në një gjendje të dëshiruar plotësisht të krahasueshme dhe konkurruese me kërkesat e një shteti modern e ligjor. Në vazhdim të këtij shkrimi trajtohen vetëm dy linjat e para të përmendura më lart, dhe në vartësi të reagimit dhe të interesit që do të shprehet e tregohet nga opinionet dhe qarqet e interesuara shqiptare, linja e tretë mund të trajtohet më gjerë në një shkrim tjetër të veçantë.

Në hapësirën e këtij shkrimi nocioni shtet përfshin legjislativin, ekzekutivin dhe interpretimin e zbatimit të ligjit, d.m.th.: parlamentin,

qeverinë ose këshillin e ministrave dhe gjykatën në tërësi. Shteti modern e ligjor ka një sërë funksionesh ndër të cilat më të rëndësishmit janë: funksioni ekonomik, funksioni publik, funksioni social, funksioni ushtarak, funksioni diplomatik dhe

funksioni politik por brenda kësaj tërësie këtij shkrimi trajtohen: funksioni publik, funksioni ekonomik dhe funksioni social. Sipas mendimit tim pagja dhe rëndësia brenda një shoqërie të emancipuar është rezultati më i kapshëm dhe më i dukshëm i këtyre

tre funksioneve të shtetit në fjalë.

Ky shkrim nuk pretendon absolutisht dhe në asnjë mënyrë që të zëvendësojë ose të shpjegojë përmbytjen që mësohet në lëndët mbi teorinë e shtetit, të administratës publike dhe shkencave sociale në nivelin universitar ose pasuniversitar.

Ky shkrim është thjesht përmbledhje mendimesh nën një këndvështrim analitik dhe vëzhgues i përvojës jetësore dhe të punës së vetë autorit.

→ Vijnë në faqen 14

Në këtë numër: PIER PAOLO PASOLINI, ARDHUR NGA AIDA BARAJ DHE EDON QEZARI; KOSTANDIN RISTANI; ARBEN MEKSI, STEFAN TAÇI, GAZMEND LEKA ARDHUR NGA JOSIF PAPAGJONI; MAJLINDA KELMENDI DHE EDISON ÇERAJ, NDUJE DEDAJ...

A

ARGUMENT

Ushtraku kanadez me origjinë shqiptare, pjesë e strukturave të NATO-s, në këtë shkrim të gjatë, që do të vijojë në disa numra tregon konceptin e tij për një shtet demokratik, si Shqipëria, duke pasur parasysh kushtet e saj. Në formën e një traktati, autori mëton të përcjellë shumë mendim, por mbi të gjitha një koncept të drejtë dhe fair, të vendit të tij, që të jetë pjesë normale e komunitetit demokratik të botës...

Përshtetimi i disa nga funksioneve më kryesore të një shteti modern dhe ligjor

NGA KONSTANDIN RISTANI*

Garantimit i paqes, qetësisë, rendit dhe rregullit brenda një shteti dhe shoqërie kërkon njohjen, zbatimin dhe harmonizimin e të gjitha funksioneve për të cilat shteti është i angazhuar detyrimisht nga ligji themelor - kushtetuta - e vendit dhe moralisht nga premtimet, kushtet, rrethanat e tradita sociale. Këto funksione materializohen në programet e ndryshme afatgjata dhe afatshkurtëra të ligjvënura ose të kontraktuara publikisht nga shteti modern ligjor. Për të bërë të mundur vazhdimësinë e qeverisjes dhe të administrimit, shumë nga funksionet e shteti modern ligjor bëhen të kapshme, të dukshme e të ndjeshme nëpërmjet shërbimeve të vazhdueshme e afatgjata me të cilat shteti furnizon e pajis anëtarët e shoqërisë që i kanë dhënë mandatin nëpërmjet zgjedhjeve direkte të përgjithshme ose nëpërmjet delegimit - nga disa mendimtarë të fushës së shkencave politike dhe filozofike kjo quhet edhe "social contract" d.m.th. "marrëveshje shoqërore". Këto shërbime afatgjata janë të pavarura nga radhëja politike e parlamentit dhe nga grupimi politik që formon qeverinë; p.sh. pajisja me certifikata lindje, me pasaporta apo me leje për drejtimit automjeti të shtetasve është e pavarur nga ose kush forcë politike është në fuqi. Po e njëjta gjë mund të thuhet edhe për procesin e vjeljes së taksave e të ardhurave nga shteti. Si rrjedhim edhe administrata publike që merret me këto shërbime apo procedura s'ka se pse të jetë e varur nga ndryshimet politike në parlament apo qeverisje kombëtare ose lokale ofortë; kjo veprimtari vazhdon pandërprerje përsa kohë shteti e ka caktuar si një domosdoshmëri pajisjen e shtetasve me këto lloj dokumentash apo mbulimin e veprimtarisë së tij e shpenzimeve të tjera me këtë lloj të ardhurash. Po kështu mund të themi edhe për "census"-in që në shqip përkthimi i saktë është "regjistrim" por që në përbajtje dhe në tërësi lë shumë veprimtari pa u përkthyer ose nënkuptuar.

Paraprakisht forcat politike mendohet që të kenë arritur atë pjekuri politike dhe janë të emancipura deri në atë nivel sa të kuptojnë e të pranojnë pa bishta e hile domosdoshmërinë e shërbimeve afatgjata bazë dhe themelore të individëve e subjekteve që përbëjnë shoqërinë që ato qeverisin e drejtojnë. Kjo për faktin se asnjë forcë politike s'është e interesuar për t'u përplasur me elektoratin e vet për shërbime që konsiderohen jetike nga shteti dhe të gjithë subjektet e shoqërisë. Vendet me një shkallë emancipimi shumë të lartë politiko-shoqërore disa nga këto shërbime i kanë mbështetur në Kartën e të Drejtave Themelore të Individit që



paraprin ose zakonisht plotëson kushtetutën e këtyre vendeve. Gjithashtu në një shtet modern e ligjor forcat politike, të çdo spektri e krahu qofshin, janë jashtëzakonisht të interesuara që administrata shtetërore dhe publike të vazhdojë punën e pasqetësuar nga ndryshimet politike ose rrethanat e jashtëzakonshme të krijuara brenda dhe jashtë vendit për arsye të ndryshme. Pra, shteti modern dhe ligjor nëpërmjet konsensusit politik për funksionimin e administratës publike, për shërbimet afatgjata dhe themelore publike si edhe kundrejt individëve të shoqërisë që ai drejton, siguron vazhdimësinë e nevojshme dhe të domosdoshme për funksionimin e shtetit në çdo rrethanë. Gjithashtu po nëpërmjet konsensusit forcat politike caktojnë dhe pranojnë pozicionet më të larta të administratës shtetërore prej ku ndahet emërimi nga konkurrimi e si pasojë stafi politik nga stafi burokratiko-administrativ. Funksionet me emërim po ashtu ndahen në politike dhe në teknokratiko-burokratike; të parat nuk i rezistojnë lëkundjeve dhe ndryshimeve politike ndërsa të dytat, sipas rastit konkret dhe në vartësi të kontratës dhe detyrimeve kontraktuale të nënshkruar para emërimit, i nënshtrohen shumë më pak ndryshimeve politike.

Funksionet me konkurrim quhen pozicione dhe janë të aprovuara paraprakisht nga një instance ndërkastetiale dhe asnjë titullar, ekzekutiv dikasteri apo qeveri s'ka asnjë të drejtë të emërojë, pushojë, marrë në punë, krijojë apo eliminojë këto pozicione sepse ka të bëjë me fondin e pagave të buxhetit të shtetit. Asnjë ndryshim politik s'mund t'i preki këto pozicione dhe burimin njerëzor që ka këtë pozicion, veçse në rastet e parashikuara dhe rregulluara me ligj, kontratë grupi ose

Forcat politike

Forcat politike ligjërojnë me konsensus funksionet shtetërore që emërohen prej qeverive të tyre por që dalin jashtë kontrollit të qeverisë fill pasi bëhet emërimi dhe nuk preken dot, veçse në rastet e parashikuara me ligj. Shembulli më tipik i kësaj kategorie janë gjykatësit por jo prokurorët. Për të përcaktuar një pozicion të tillë në një shtet ligjor dhe modern ka procedura dhe konsiderata të caktuara të cilat nuk janë objekt analize i këtij shkrimi.

kontratë individuale. Dikasteret propozojnë strukturën e nevojshme për të funksionuar dhe përshtetimin e detyrave dhe veprimtarisë që u takon këtyre pozicioneve; aprovimi bëhet nga instanca që aprovon shpenzimin e fondeve publike të pagave për gjithë administratën shtetërore kombëtare; punësimi për pozicionet bëhet në bazë të përshtetimit të detyrave dhe të aftësive e cilësive të kërkuara më parë e të testuara më pas me konkurrim para komisionit të aprovuar për këtë qëllim, pasi është shpallur e publikuar vendi vakant apo i ri nga komisioni i punësimit publik ndërkastetial. Komisioni i punësimit publik ndërkastetial ka edhe gjykatën e vet të apelit për të shqyrtuar ankesat dhe parrregullsitë e vërejtura nga kandidatët ndaj komisionit të aprovuar për të mbikëqyrtur e vlerësuar testimin e tyre.

Së fundi forcat politike ligjërojnë me konsensus funksionet shtetërore që emërohen prej qeverive të tyre por që dalin jashtë kontrollit të qeverisë fill pasi bëhet emëri-

mi dhe nuk preken dot, veçse në rastet e parashikuara me ligj. Shembulli më tipik i kësaj kategorie janë gjykatësit por jo prokurorët. Për të përcaktuar një pozicion të tillë në një shtet ligjor dhe modern ka procedura dhe konsiderata të caktuara të cilat nuk janë objekt analize i këtij shkrimi.

Si prirje e përgjithshme, një shtet modern e ligjor, i ndodhur përballë trysnisë gjithmonë e në rritje nga ana shoqërisë, grupeve dhe individëve që ai përfaqëson, përpiqet të ndajë sa më shumë që të jetë e mundur administratën e shërbimit publik nga militancizmi partiak, patronazhi politik dhe partizanizmi subjektiv si mënyra veprimi që në perspektivë dëmtojnë të gjithë anëtarët e shoqërisë pa përjashtim dhe asnjëri nuk del i fituar - filozofia moderne këtë fenomen e krahason me të ashtuquajturën "dilema e të burgosurit".

Veç shërbimeve afatgjata dhe themelore shteti ofron ndaj individëve dhe grupeve të ndryshme shërbime afatshkurtra dhe programe. Këto janë objekt i konkurrencës dhe premtimeve elektorale të bëra nga forcat politike. Ky shkrim nuk ka për qëllim të analizojë dhe të japë shembuj se si organizohen, mbikëqyren dhe realizohen këto shërbime dhe programe, por një shembull përfaqësues i këtij grupi shërbimesh apo programesh mund të jetë indeksimi i pensioneve të pensionistëve me treguesin vjetor të inflacionit. Një qeveri tjetër e një grupimi politik të ndryshëm nga ajo që e filloi këtë program mund ta ndryshojë apo ndërpresë përkohësisht por edhe përfundimisht këtë program për sa kohë është në pushtet dhe ka mandatin e zgjedhësve.

Një nga funksionet më të rëndësishme e më kryesore të shtetit modern dhe ligjor është ai ekonomik

nëpërmjet të cilit shteti lehtëson e harmonizon krijimin dhe zhvillimin e mardhënieve të pronës, të prodhimit, të shkëmbimit, shërbimit e kontraktuale që rrjedhin si pasojë e tyre si edhe i mbron e ndërmjetëson këto marrëdhënie me ligj. Ky shtet nuk krijon marrëdhënie të reja por krijon kushte që shoqëria dhe veprimtaria e gjithanshme ekonomike e saj të krijojë marrëdhënie të reja, vazhdimisht në ndryshim, pa imponim dhe vetëm nëpërmjet qetësisë dhe rregullit. Ai gjithashtu paraprin me ligje e rregulla çdo zhvillim të mundshëm të ardhshëm të këtyre marrëdhënieve. Shteti i ndërtuar mbi bazën e marrëdhënieve të ekonomisë së tregut ka kryesisht në qendër të vëmendjes dhe veprimtarisë pronën dhe kontratën si dy shtyllat kryesore të ekzistencës dhe zhvillimit të shoqërisë që ai përfaqëson. Me këtë lloj shteti s'bëhet shaka me trajtimin, mbikëqyrjen, keqpërdorimin, keqadministrimin dhe jetësimin e pronës dhe me ortodoksinë e rreptësinë e zbatimit dhe mbrojtjes së kontratës e cila përfaqëson marrëdhëniet e lira të shkëmbimit ndërmjet subjekteve ligjore e sociale.

Tjetër aspekt shumë i rëndësishëm dhe jetik i funksionit ekonomik të shtetit modern e ligjor është krijimi, ruajtja, shumimi, administrimi dhe mbikëqyrja e të ardhurave publike. Në këtë funksion një burim i padiskutueshëm i krijimit të të ardhurave janë taksimi i të ardhurave kolektive apo personale të anëtarëve të shoqërisë, taksimi i fitimit neto të çdo njësie të vendit apo të huaj me veprimtari ekonomike të regjistruar në territorin e vendit që ka nën juridiksion dhe së fundi taksimi i çdo prone të paundshme nga administrata vendore. Taksat shpesh herë marrin edhe formën e pagesës për një shërbim të caktuar që shteti u ofron antarëve të shoqërisë që ai përfaqëson; këto pagesa sipas rastit mund të jenë të plota për të mbuluar shpenzimet ose simbolike për të mos u abuzuar nga shërbimet të pajustifikuara dhe të shpeshta të shërbimit. Shembull nuk janë objekt i këtij shkrimi.

Këtu merr një rëndësi shumë të veçantë vartësia e ndërlidhja e ngushtë, e ndërsjelltë dhe e pandashme e zbatimit të ligjeve të taksimit nga njera anë dhe inventarizimit të detyruar fizik e të regjistrimit fillestar e pastaj të vazhdueshëm periodik nga ana tjetër, të të gjithë objekteve e subjekteve që ushtrojnë veprimtari brenda të gjithë territorit nën juridiksion. Inventarizimi dhe regjistrimi nga ana e tyre kërkon si kusht paraprak ndarjen gjeografike, territoriale e administrative me kode të veçanta njëore identifikimi dhe adresimit të pa ngatërrueshëm, si edhe identifikimin e adresimit në po

të njëjtën mënyrë të të gjithë subjekteve qëndrujes e veprues brenda juridiksionit.

Të ardhurat publike si i vetmi burim i financimit të shtetit, shërbimeve dhe programeve që ai ofron, krijohen në forma të ndryshme dhe shteti përdor të gjitha mekanizmat që i lejon ligji apo krijon ligje për t'i krijuar e mbrojtur ato dhe që nuk janë objekt i këtij shkrimi. Krijimtaria e politikanëve dhe burokratëve të administratës shtetërore asnjëherë nuk rrishte menduarit e prodhuarit burime të reja të ardhurash publike. Një nga shembujt më të spikatur të kësaj krijimtari është nxitja, mbështetja në të gjitha format dhe lehtësimi i veprimtarisë ekonomike private të çdo niveli qoftë duke penguar dhe luftuar vazhdimisht krijimin e monopoleve, nëpërmjet lehtësimeve që i krijohet konkurrencës së lirë dhe të ligjëshëm në favor të blerësit e përdoruesit, qoftë edhe nëpërmjet kredive direkte për të ushtruar veprimtari ekonomike apo përjashtimeve të përkohshme nga detyrimet taksuese.

Shteti modern ligjor është shumë i ndjeshëm ndaj gjendjes së përgjithshme sociale të individëve të shoqërisë që ai drejton. Shteti gjithmonë është i interesuar që të krijojë, mbrojë dhe inkurajojë rregullin dhe paqen sociale në girin e shoqërisë dhe ndërmjet individëve e grupeve që e përbëjnë atë. Për këtë arsye një shtet modern i emancipuar e ligjor përdor parimin demokratik të shumicës duke respektuar dhe marrë parasysh kërkesat specifike të pakicës dhe njëkohësisht respektimin e tyre. Sidomos i kushtohet kujdes nëpërmjet programeve të ndryshme shtresave më të paprivileguara e më të pambrojtura të shoqërisë. Kështu shteti ligjor e modern garanton dhe zbaton shërbime dhe programe të barazvlerëshme për të gjithë individët e subjektet e shoqërisë që drejton pa përparësi e preferencë. Kjo bën që secili individ e subjekt të ndjehet i respektuar, i përfillur dhe i shërbyer me të njëjtat vlera të cilat janë të pavarura nga origjina, gjinia, funksioni, pasuria, pozita, detyra, shkalla shoqërore, arsimimi, raca, besimi etj. dhe çdo elementi të tillë që përbën shkak potencial për përplasje sociale, diskriminimi dhe injorimi të pakicave e grupeve të ndryshme.

Shteti krijon forma, metoda dhe tregues të stërtholluar matje dhe kontroll të kënaqësisë ose pakënaqësisë sociale dhe merr masa të menjëhershme kur vëzhgon se këta tregues janë jashtë parametrave të pranuar si normale. E gjithë kjo shpjegohet thjesht me funksionin ekonomik të shtetit në shërbim të marrëdhënieve ekzistuese dhe të të ardhurave sepse çdo turbullirë sociale bëhet shkak për mosgaranci dhe paqëndrueshmëri investimesh gjë që në perspektivë dëmton rëndë ekonominë dhe çon në dështim politik. Ndaj paqja sociale, në ndryshim nga gjykimi klasik dhe arkai i sistemit të ekonomisë së tregut si "i egër" dhe "i pa-shpirt", merr një rëndësi të veçantë për shtetin modern dhe ligjor që drejton dhe zbaton ligjet e ekonomisë së tregut në kushte të reja sociale.

Si përfundim i kësaj paraqitje të thjeshtë e të përgjedhur shteti modern ligjor i shoqërive të emancipuar perëndimore është një shtet përfaqësues, rregullues, mbrojtës, ndërmjetësues, funksionues dhe shërbyes për shoqëritë që ai drejton dhe që është i mandatuar nëpërmjet "marrëveshjes shoqërore".

***Titulli origjinal që bashkon të gjithë traktatit është Një analizë krahasuese e vlerësime mbi disa nga funksionet e shtetit shqiptar në raport me ato të një shteti modern**

T

TREGIM

NGA NDUE DEDAJ

1
Po priste pranverën për t'i ndërruar tjegullat kullës, pasi gjatë dimrit çatia i kishte futur ujë, në dy-tre vend. Cirka kishite rënë dhe mbi një armë e pak fiskekë që mbante fshehur në tavan që nga koha e Luftës, kur kulla për pak kohë qe kthyer në shtab partizan. Nuk kishte thënë as po e as jo atë ditë që partizanët ia kishin mësy derën, megjithëse ata as që e kishin prituri pohin e tij, por kishin hyrë drejt e brenda. Ishte vjeshta e 44-s dhe tashmë nacional-lirimtarët ndiheshin kudo në shtëpinë e tyre. Punë ditësh e flamuri do të valvitej dhe në shkrepat më të lartë të atyre bjeshkëve.

Kulla e tij në kodrën përballë qendrës së Nënprefekturës, një qytezë e vogël që nga shekulli i kaluar, ngjante si një këshqjellëz që e kishin lakmuar gjithnjë luftëtarët qysh nga koha e Pavarësisë. Një gojëdhënë e stërmoçme thoshte se mungadën e atyshme e kishte pas themeluar vetë Shën Pali, kur kishte shkelur aty anëve, në udhëtimin e tij biblik drejt Adriatikut.

Kishin kaluar shtatë vite nga Lufta e plagët e saj po shëroheshin pak nga pak, diku hapje një rrugë e diku vihej një urë, ishte rihapur dhe miniera e kohës së Zogut. Bash kur mendonte se i kishte ujdisur punët me qeverinë e po përgatitej t'i ndërronte tjegullat kullës, në oborr u shfaqen tre shokë të Këshillit, fytyrë-vërejtur si asnjëherë, të cilët i thanë se duhej prishur kati i tretë i kullës.

Nuk po ju kuptoj?! - u tha i zoti i shtëpisë.

Si nuk na kupton? Ne shqip po flasim. Kati i tretë i kullës duhet të shembet përdhe, brenda 15 ditëve. Ky është vendimi i Komitetit. Ja dhe procesverbali që duhet të nënshkruash se morenjoftim...

Burri vërtet që nuk po kuptonte asgjë. Ku ai e ku ata! Ai donte t'i hiqte pikën kullës, kurse ata vinin ditën për ditë dhe i thoshin shërbes-shërbes se kulla e tij duhej të shkonte për dhjamë qeni. Kur ai u kërkoi sqarim, se pse duhet ta shembte kullën, që ishte e tijja, gjysh mbas gjyshi, ata rrudhën buzëz dhe ikën duke shënuar "refuzon të nënshkruaje procesverbalin". Pas një ore erdhën policët e Lokalitetit dhe e shoqëruan për të Kryetari. Ky i bëri me dije shkaku e atij vendimi të paimagjinueshëm.

...Kujtohu mirë se çarë ka ndodhur... atë ditë... në kullën tënde! Sa më shpejt të na rrëfeshesh neve, shokëve të pushtetit, aq më mirë do të jetë për ty. Mbase nuk dëshiron ta vizitozh Burgun e Shkodrës!? I zoti i kullës në kodër e kuptoi se e

Një tregim, që duhet të ketë bazë të vërtetë, dhe duke i hequr pjesën e vockël të paragjykimet është i këndshëm. Por edhe si gjetje mund të vlerësohet nga autori që e ka trajtuar me sensin e masës...



BORIZANI

kishte punën keq. I tha Kryetarit se shtëpia e tij kishte qenë bazë e Luftës, bile seli e shtabit partizan, se për dy javë i kishte prituri e përcjellë partizanët me ç'kishte pasur. Janë vetëm shtatë vjet në mes. Jo shtatëdhjetë. Të gjithë e dinë këtë gjë këtu. Ju kenë ardhur nga larg dhe mbase nuk ua kanë thënë... Pastaj, shoku Kryetar, Partia ka letra, në mos në rreth, në Tiranë. Me siguri diku në dokumentet e Luftës është shkruar se ku qëndruan partizanët në kulmin e luftës, kur u çlirua krahina jonë.

Hëm, të thashë, kujtohu mirë, mos na trego neve përralla patriotike! Në shtëpinë tënde është vuarë një partizan. Pikë. Borizani i Brigadës X... Sulmuese. A nuk e ka lapidarini në cepin e oborrit tënd? Burri i kullës u tronditi. Nuk po u besonte veshëve. Nuk po e mbanin këmbët. Çfarë po thoshte Kryetari i... shtetit? Si ishte mundur të përmbyste e vërteta aq papritur?

2
Kishte qenë mesi i tetorit '44. Po vinte mesdita dhe një enë e madhe dheu ziente goshë me mish në kuzhinën që ishte në katin e parë të kullës. Befas kulla u drodhi nga një predhë mortaje, si nga tërmeti. Komandanti thirrri rojat që ishin jashtë dhe ata i thanë se po shtinin partizanët e batalionit të pestë nga ana tjetër e lumit, duke vrikuar për të kapur qendrën e Nënprefekturës. Komandanti vrau mendjen se si t'i bënte me dije ata të batalionit matanë (teksta ndër-lidhja ishte ndërprerë papritur), se kishte ardhur më parë batalionit i tretë dhe ajo kullë kishte dy javë që nuk ishte më në duar të Reaksionit, por ishte kthyer në seli e shtabit partizan. Aty ishin vetëm një dorë partizanësh: vetë ai (komandanti), borizani, mjeku i batalionit, një partizan i plagosur, dy vajza partizane dhe dy rojat përjashta. Borizani ishte bërë i famshëm për borisë e tij, me të cilën jo vetëm ngrinte peshë batalionin

e më pas Brigadën, sa herë lëshohet kushtrimi, por si njeri hokatar që ishte, improvizonte dhe pjesë muzikore duke argëtuar partizanët në kohën e pushimit. Njera nga vajzat partizane, intendentja, nuk i ndahej dhe thurte ëndrra me të kur të vinte liria. Borizani do të mësonte në Konservator e do të bëhej muzikant, mendonte ajo. Sakaq, një tjetër predhë e gjuajti kullën dhe disa copa tjegullash ranë poshtë me rrapëllimë. Borizani nuk prituri urdhër, por doli në oborr dhe i ra borisë, fort, gjatë... Por ata, andej matanë lumit, nuk donin t'ia dinin. Fundja bori kishin dhe të tjerët, kundërshtarët e tyre nacionalistë dhe mund të ishin ata duke i rënë. Në atë kaos, kur një palë ishte në dëshpërim dhe një palë tjetër vinte me trumpetë, ec e merre vesh se e kujt ishte ajo bori, që për herë të parë po e tradhonte të zotin. Predhat sa vinin e shtoheshin mbi qoshet, trarët dhe dritaret e kullës. Atëherë komandanti i kërkoi borizanit të dilte në katin e tretë të kullës, pasi atje me siguri zëri i borisë së tij do të degjohet nga shokët e tyre partizanë atje tej.

Borizani ngjiti me të shpejtë shkallët e drunjtë të kullës, që kërcisnin nën hapat e tij të rëndë, nxori borinë në njërën nga dritarët e korridorit dhe zëri i saj buçiti vetëm njëherë... pasi trupi i tij u shemb përdhe mbi dërrasat e çardakut. Atë cast boria kishte fluturuar nga dritarja e kullës e drejt e në oborr, si një shpend që sapo kishte dhënë shpirt.

Komandanti dhe i zoti i shtëpisë qenë dy të parët që e morën trupin e pajetë të borizanit dhe e ulën në katin e parë. "I ka lufta këto", tha një frazë si për të qetësuar atë, apo vetveten komandanti. Burri i kullës ishte tepër i tronditur. Nuk kishte bërë vaki me vdek ndonjë luftëtar në kullën e tij. I pari ishte ky partizan i ri që i kishte hyrë në zemër. Nëse ai do t'i dinte zakonet

e vendit, nuk do të dilte në dritare, ballazi me ata që shtinin nga përtej lumit, por do të kishte vajtur të sheshemi, do ta nxirrte që aty grykën e borisë dhe me siguri plumbi nuk do ta kishte zënë...

3
Në anët e Trebeshinës, andej nga kishte qenë borizani, kishin dalë fjalë se atë e kishin vuarë shokët e tij partizanë. Pa dashje. Kur i ati mori udhën për të takuar Komandantin në Tiranë, shokët e Ministrisë së Brendshme vendosën t'i dëllin përpara situatës. Si mund të pranohej nga lavdimëdhentë se kishin gabuar në Luftë, duke vuarë një shokun e tyre? Kjo nuk mund të hahej. Partizanët kishin vuarë vetëm gjer-manë e tradhtarë, por kursesi partizanë. Si mund të venin veteranët në shkollë e të thoshin, po, ne kemi gabuar ndo-një-he-rë, kemi vuarë pa dashje një shokun tonë, borizanin e Brigadës X... Jo, jo, as që mund të shkohej nëpër mend. Dhe kështu iu poq kulcaj burrit të kullës në kodër, që më pas do të shpallej kulak me farë e me fis. Partia sakrifikoji jo vetëm nderin e një kulle malesh, por dhe një bazë të vetën të Luftës, vetëm e vetëm për të mos pranuar as atë që vetë marksizmi e thoshte, që dhe dielli kishte njolla...

EPILOG

Kur punëtorët po bëheshin gati të shembnin katin e tretë të kullës, i zoti i saj u ngjiti në tavan dhe mori pushkën, që e mbante fshehur që nga koha e Luftës. Por, sapo ai ra aty te sheshemi, u dëgjua një krismë e thatë. Mbase arma i plasi në dorë. Mbase?!...

Atë pranverë nuk u shemb vetëm kati i tretë i kullës së "Kulakut", siç do të thirrej ai më vonë, por të gjithë katet e treta dhe të katërta të kullave të asaj krahine veriore të degjuar në histori. Nuk mund të vazhdonin të ishin ashtu të larta, ato, duke iu bërë hije shtëpive të shokëve të Luftës...

P

POEZIA

Dy përkthyesit e këtij libri mendojnë se u kanë ofruar të rinjve shqiptarë shembullin e intelektualit të angazhuar, të një personazhi të përhershëm për pushtetet, që ngriti zërin pareshur kundër kapitalizmit dhe parashikoi rrënimin e shoqërisë së konsumit.

"MISH DHE QIELL"

"Mish dhe qiell" është një përmbledhje me poezi kushtuar kryesisht të rinjve. Përzgjedhja e bërë me kujdes është shumë kuptimplotë për t'i shoqëruar lexuesit dhe veçanërisht të rinjtë në botën e poetit Pier Paolo Pasolini. Përmes tyre del në pah fuqia e tij shprehëse dhe përfytyruese. Boshiti rreth të cilit enden të gjitha poezitë është dashuria, si një fjalë kyç drejt zemrës së rinisë, si dhe angazhimi qytetar, si shenjë e një vetëdijeje të përkur shoqërore.

Këto poezi mund të lexohen, të recitohen, të kopjohen, të dhurohen: për të gjithë të rinjtë që, falë një libri, arrijnë të shprehin ndjenjat e tyre më të thella dhe komplekse.

Libri është i pajisur me një indeks të përgjithshëm të veprave të Pasolini-t, në letërsi, kinematografi, teatër etj.

"Vizioni im është apokaliptik. Por sikur pranë tij dhe ankthit prej të cilit lind, të mos kisha brenda vetes edhe një element optimizmi, domethënë mendimin se ekziston mundësia për të luftuar kundër gjithë kësaj, nuk do të isha duke folur këtu, mes jush," është një prej deklaratave më të forta të Pasoliniut, me vlerë të gjithkohshme dhe të përbotshme.

Pier Paolo Pasolini
Mish dhe qiell



NGA PIER PAOLO PASOLINI

VËLLAIT

Ti kisha të drejtë, vëlla, atë mbrëmje - e mbaj mend mend mirë - kur the: "Në dorën tënde ke të shënuar shenjë e dashurisë dhe të vdekjes". Qeshje, ti, vërtet, por unë isha i sigurt. Tash lërmë t'i bie kitarës dhe të shoqëroj ditën.

(1941)

**NË KATUNDIN E
"GJINESHTRËS"3**

Një shekull e prapë asgjë; fort larg, për një çast të shuar në atë mal, ku prapë ngjaje paksa i përjetshëm, edhe i gjallë kur ishe. Dhe në trupin tënd të ngrohtë dukej si turmë koha; në trupin tënd që pavetëdijshëm, dhe i përunjur, zbonte në hije, mijëra jetë, ngaqë të panjohura ishin. Tash po shlyen harenë tënde, tëndin buzagaz ëmbëlsisht ironik; dhe nëse, mosbesues, të jepte zemër për të parë të fjeturit, dhe mbledhje supet, ja tek je i mundur për një çast të mjerë. Unë mund të kem mëshirë për ty, në të befason kjo vetëtimë vitesh, dhe ky bosh i qetë që përplasat mbi kohën tënde. Ja trupi yt i lakuriqtë, ja njëqind vjet dëshmitarë shpërfillës.

Versuta, 14 mars 1945

VAJI I DHEGËRMUESES

I
Veç të dashurosh, veç të njohësh ka rëndësi, jo t'kesh pas dashuruar, t'kesh pas njohur. Ankhth ngjall

përjetimi i një dashurie të konsumuar. Shpirti mbetet në vend. Dhe ja në ngrohtësinë e magjepsur

të natës, që e plotë ka rënë mes gjarpërimesh të lumit dhe vegimesh të përgjumura të qytetit mbjellë dritash,

jehon ende me mijëra jetë, tëhuajtja, misteri, dhe mjerimi i shqisave, m'i kthejnë në armike

trajtat e botës, që deri dje ishin arsyeja ime e gjallimit. I mërzitur, i lodhur, kthehem në shtëpi,

nëpër të zezat sheshe tregjesh, rrugësh të trishita përreth porteve lumore, mes barakave dhe magazineve përzier me lëndinat e fundit. Atje, vdekatare është heshtja: por tej, në rrugën Marconi, në stacionin e Trastevere, e butë

ende duket mbrëmja. Në mëhalla, në lagjet e periferisë kaluar mbi motorë të lehtë - me tuta apo pantallona

pune, por plot afsh djaloshtar - kthehen rioshët, me shokët mbi shalë, buzagaz e të palarë. Myshterinitë e fundit

më këmbë, me zë të lartë llafosin nëpër natë, tek tuk, nëpër tryezat e bareve të pastra e gjysmë të zbrazura.

I mjeri e i mrekullueshmi qytet,



që më mësove atë çka me gazmend të egër burrat e nxënë qysh fëmijë,

gjërat e vogla ku madhështia e jetës së paqetë shfaqet, si të bëhesh i fortë dhe i gatshëm në rrëmujën

e rrugëve, t'i drejtohen një tjetri syapatrembur, të mos turpërohen tek shohin paratë që numëron faturinoja me gishtërinj dembelë që djersin përkundruall fasadave që rëndin me një bojë të përjetshme behari;

që të mbrohem, të shaj, ta kem botën përpara sysh e jo vetëm në zemër, që të kuptoj

se pakkush i ka njohur pasionet që kam përjetuar: se ata dashamirës s'më janë, megjithatë

vëllezër më janë bash në pasionet njëzërorë që kemi, që të hareshëm, të pavetëdijshëm, të plotë

përjetojnë përvoja të panjohura për mua. I mjeri e i mrekullueshmi qytet që më shtyve drejt

përvojash të asaj jete të panjohur: gjersa më zbulove se, te secili, një botë e tërë ish.

Një hënë duke dhënë shpirt në heshtjen, që me atë jeton, zbardh mes afshesh të nxehta që mjerueshëm mbi tokë ndërron faqe, me udhët e bukura, rrugicat e vjetra, pa u dhënë dritë lëbryrin dhe, në gjithë botën, i pasqyro

atje lart, në të dendurat re. Është nata m'e bukur e verës. Trastevere, me një erë kashte

prej stallash të vjetra, pijetoresh të boshatisur, ende nuk fite. Qoshet e errëta, muret e bindura

jehojnë nga zhurmat e magjishme. Burra e fëmijë kthehen në shtëpi - nën vargje dritash tashmë vetmitare -

drejt rrugicave të tyre pllakosur

nga terri dhe pëlhërishtja, me atë çap të lehtë që dikur shpirtin kisha plot

kur me t'vërtetë dashuroja, kur me t'vërtetë doja të kuptoja. Dhe, si atëherë, zhduken duke kënduar.

Përkthyer nga Aida Baro

ENGJËLL I PËRLYER

Ja tek me gjen plot afërimit të pakufi tok me timen prani, engjëlli i përlyer që dua. Ç'lahtar shterpësi ysh nëse prek trupin që djalos dashuroja se i bindur isha për dashurinë. Por nuk di të tmerrroj, e as veten të braktis... Zotit që nuk sjell jetë i lutem të mos vdes.

MADRIGAL MADHËSHTOR

Ti, flutur shpirt-re lehtësi bezdisëse prej rrjedhe pranverore mes kthjelltësisë dhe flashkësisë së plepave të dashur dhe shkurresh idhnake, flutur, myshk i gjallë, era e të cilit ka dy flatra të marra që pasqyrojnë Prizmin me fytyrën e vet portokall dhe jeshil, ti e vdekur s'ke asgjë që të të humbasë, asgjë në të cilën të marrë flakë a t'i kallë datën myshkut tënd vetjak, kjo re e një jete shtazore njomëzaku.

Lumturi që gjakoset, gërthet, mendje që digjet, nerv i shkalluar, i Burgosuri qesh tekta të jepet pa pikë mëshire për të ardhmen e tij të pabesë.

Përkundrazi, do të vdesë butësisht, të shqejë me një të fundmë ledhatim prej gjoksit zemrën aq të dehur. Di që dashurinë e vet tërë gaz riosh nesër do ta presë një fund i errët, di se do t'jetë agimi që do të shembë natën e këndshme të së dielës. O Parajsë ku njëmijë barka shpalosin vela të kristallta! ku detari i nxehtë dhe i zbehtë prej dëshirës, shtrirë mbi bash,

këndon mbi kitarë udhëtimet që bëri, Korrikë magjikë dhe Maje tërë afsh... Në ty gjendet kujtimi ledhatar. Dridhma dashurie zënë velën e mbështjellë. Deti puth shkëmbinjtë e përgjumur. Asnjë barkë s'niset, ani velat erës i shpalosen butësisht.

A s'mendon dheun tënd të braktisur, atje ku, margaritar bardhëllor në peshtaf, vallëzon nusja shndërruar në mjellmë, tekta flautet e një përballjeje të kulluar s'e krisin qetinë e detit!

Brenda zemrës sate me dëshirë trandet një çast i vetëm, oh ju vite mrekulli, i një vdekejeje që jeton Kohën për ty: veten tënde mund ta sakatosh butësisht, të tjetërsosh arratitë dhe shpresat, qelia jote është një pushim i përjetshëm. Po e ardhmja? Jo! Hesht zë i urryer! Së ardhmes ai s'ndi tjetër vegjë t'i ikë, lumturi e tij

s'ka të ardhme, ka orekset e fëlliqura të djaloshtit mes çarçafësh të vakët, të fluturës që rreshqet në fluturim për të vuajtur, të piratit të dehur që dridhet tekta ledhator perla dhe gjak, s'di më të llogarisë kohën dhe fishket në tmerrin e përlurur të nuses që i trembet njeriut dhe të rendë s'guxon.

I Burgosuri ka zemrën e një dallëndysheje që ballë oqeanit ledhator udhëtimi i njohur është në dorë të dehjes. Pas pak do t'zhduket, larg do të jetë! Pret mbate të perëndojë dielli... por dielli s'perëndon; mbase do t'i japë një soditje të fundit dheut të dashur ku meridiani shënon orët e lumturisë dhe ngrohtësisë... Ani, mbi meridian s'lëviz hija përgjatë shifrave të ngecura nën diell.

TRONDITJE LUMTURIE

Nxitjen prej larti që botës t'i jem falë, mandej, heshtja vetë ma jep dore. Syri i vogëlushit mirënjohës ndal zemrën, me mizorinë e tij gazmore.

Gjith' kësaj dashurie s'i ngre dot pritë, puthjeve që jep e merr veç brenda një nate! Jep gjakun, marrok i dashuruar, syperit prej hijeshie, të ndal zemrën fluturake. Tronditje lumturie e marrë, natë Malafieste7, zot dhe i pajaf dikur unë isha: tjetër çfarë të dojë jeta ime veç vdekjes së saj? I rritur? Assesi - assesi, siç vetë qenia nuk rritet - përherë mbetet aguridhe, nga një ditë rrëzëllitëse në tjetër - mundem veç t'i mbetem besnik monotonisë së pruarit të fshehtësisë. Ja përse lumturisë nuk i jepem - ja përse, megjith' ankthin e fajësisë, mbi pendesë s'kam vënë kurrë dorë. Ortak, gjithnjë ortak me të pashpërhurën, në fillësë të asaj çka jam.

Përkthyer nga Edon Qesari

...nga numri i shkuar

"Milosao" e këtij numri duhet konsideruar si një numër i këndshëm. Kishim një argument shumë interesant, i cili lidhet me Nënë Terezën dhe rezistencën kundër saj të komunitetit katolik në Belfast. Një situatë, që ngjan si dy pika uji me situatat shqiptare. Por, Nënë Tereza me shpirtmadhësinë e saj e ka kaluar në një formë shumë origjinale. Ajo, jo vetëm vendosi të shkojë, por deklaroi se misioni i saj do të vendosej në Ballymurphy - një lagje e Belfastit që ishte bombarduar vetëm dy muaj më parë dhe shkatërruar tërësisht nga dhuna e tmerrshme. Ndrej Gjini, bashkëpunëtori ynë, argumenton të gjithë procesin sesi Nënë Tereza kohët e fundit, në vitin 1973 është përzënë dhe detyruar të largohet nga Irlanda e Veriut. Këtë akt të pashembullt e ka urdhëruar mëkëmbësi i parë i kardinalit të Belfastit, Fr. Padraig Murphy. Duhet thënë se autori nuk i bën dot "ë" dhe kjo na sjell probleme, që redaktori me kohën në dispozicion nuk i zgjidhi si duhet. Meriton një kritikë të fortë për këtë, por edhe faktin, që nuk ia bëri të ditur autorit.



Vaid Hyzoti na kish sjellë një cikël që redaktori e vendosi dhe për të cilin shkroi "Një përshkrim për jetën dhe një elegji filozofike për përballjen, e trajtuar shumë thjesht..."

Interesant duhet konsideruar edhe eseja e gjatë e Anton Papelekës, të cilën redaktori e kish lënë pak kohë. Ishte trajtuar pak me një gjendje jo të

mirë por edhe si një kritikë ndaj shoqërisë, që na rrethon. "Në Shqipëri, vlerësohet e nderohet vetëm ai që është kanakar i ndonjë partie, në gjirin e së cilës e ndien veten si veshka midis dhjamit. Atij që synon të çajë udhë me talent e me punë, të krijojë ndonjë vlerë të njëmendtë, i del përpara ledhi i pakapërcyeshëm i klaneve dhe i politikave mafioze të qeverive në fushën e kulturës. Për këto klane dhe për këto qeveri, shqetësimi për zhvillimin normal të letërsisë shqipe, për ecjen e saj së paku me hapin e letërsive të popujve fqinjë, është vrima e fundit e kavallit..."

Redaktori shtoi një argument për simbolikën e shqiponjës, duke marrë shkas nga debatet për të, ndërsa u shpreh se: "...heraldika duhet të ketë dhe një lloj uniteti, gjë që nuk ndjehet në morinë e simbolikës të re shqiptare. Një gjë e tillë ndodh shpesh, dhe pothuaj e hasim në të gjitha fushat, por kjo na bën të kujtojmë shqetësimin e madh, që sa pak e dëgjojmë mendimin profesional dhe jo vetëm. Kjo të vinte ndërmend kur artikulet të ndryshëm shtronin idenë e shqiponjës në simbolikën tonë dhe specialistë si Gjini Varfi heshtnin...sepse askush nuk kujtohet kurrë për ta".

Në përgjithësi ishte numër i mirë. U prit shumë mirë shkrimi i Papelekës për mënyrën e shtrimit dhe sinqeritetin e treguar...

OPINION

Për fat të keq, arti ynë nuk e ndihmon vendin sepse kjo do të dukej kur individit do të dinte t'i shërbejë si duhet ushqimit estetik të shoqërisë. Shqipëria (lexo: politikanët) e tregon respektin ndaj artit me egërsinë e saj, por edhe varfërinë e madhe ku e ka lënë artistin e zakonshëm shteti shqiptar. Pakkush e do ushqimin shpirtëror të këtij vendi, atë që frymëzon dhe ndryshon, sepse pakkush do ta ndryshojë realisht Shqipërinë...

Pse nuk mundet arti jonë ta zbusë politikën?!

NGA BEN ANDONI

Në këtë kohë krize të madhe politike dhe sociale të vendit duket se arti është kreu i tullatur. Ankohe dramaturgët dhe regjisorët se nuk ka pjesëmarrje në shfaqje, ankohe botuesit se nuk ka lexues të mjaftueshëm dhe gjithnjë e më pak, ankohe artistët se nuk ka frymë arti. Në fakt, jeta vazhdon dhe Tirana ka plot aktivitete kulturore. Ka ekspozita, shfaqje, filma, drama dhe aktivitete, por të gjitha kalojnë pa u ndërje sepse peshën më të madhe e ka marrë politika dhe mjedisi i saj. Janë elementët e kësaj të fundit, që janë të ekspozuar më shumë se kushdo në televizor. Sërish janë këta që vendosin për fatet e vendit, këta që thirren për të dhënë mendime për gjithçka dhe më shumë akoma. Nëse do të kërkohe artistët ata janë struktur, në kërkim të frymëzimit, por edhe shpëtimin nga ky qerthull i frikshëm, ku të gjithë bërtasin dhe anatemojnë, por askush nuk di të kërkojë këtë stepje të artit dhe mesazheve të saj.

Pse tematikat në ekspozita dhe shfaqje nuk mund të penetrojnë tek njerëzit për t'i ushqyer me kategori estetike, që mund t'ua lirojnë shpirtat? Pse arti ynë nuk deklamton? Pse nuk apelon dot? Varfëria, mbijetesja, konjuktura i kanë tullatur paq artistët dhe kjo ndihet kudo. Njerëzit janë më të egër, fjalori publik është banal dhe krejt "i natyreshëm", kurse gjërat sipërfaqësore i ndjen ngado.

Duket se e keqja ka zënë vend kudo por më shumë të politikanët, që pas kinse-statuarave fshehin hone formimi dhe një mungesë totale të ushqimit kulturor. Dhe, kjo nuk duket vetëm nga leksiku i dobët i përdorur i tyre, shkrimi katastrofik përdorur në komunikim, lënë si dëshmi e mungesës së formimit por edhe nga mënyra e shprehjes.



Më shumë akoma nga vizioni që kanë për kulturën.

Fakti është se sot libri po vuan taksa të rënda, publiku e ka të vështirë të tërheqë botimet, kurse shfaqjet po bëhen gjithnjë e më shumë me vështirësi. Ankesat vijojnë që nga projektet dhe vazhdojnë të mundësitë që i jepen artit.

A do mundej arti ta zbusë politikën? Duket se të dyja janë anët e një mekanizmi që e ka lënë vendin tonë kaq pas. A ndodh ndryshe në vende të tjera? Në vetëm pak vende është në përpjestim të zhdrejtë ky fakt. Një shoqëri e shëndoshë dhe me kërkesa të larta prodhon art të shëndoshë sepse i duhet të ruajë mirëqenien e saj shpirtërore, ashtu si një vend i mbarësuar me egërsi dhe inat dhe drejtuar nga një politikë inatçore është i destinuar të ketë ngërçe dhe një art me probleme. Paçka se këtu ka edhe shumë përzjash-

VIZATIM

Piktori "Stefos" Stefan Taçi është një nga zërat më të njohur të pikturës shqiptare. Ai i ka ofruar prej pak javësh këto imazhe të këndshme "Milosao", që kanë qenë pjesë e bashkëpunimeve të ndryshme dhe të cilat po botohen në këtë numër.


Stefos është një vizatues shumë i ndjeshëm dhe me kërkesa të larta estetike. Ardhur nga shkolla klasike shqiptare, ai ka mbetur shumë kanonik dhe tejet i vëmendshëm nga ideja, më shumë sesa përmbajtja. Duhet të vlerësohet shpirti i tij artistik dhe gjetjet e veçanta për të përcjellë mesazhet. Kurrë nuk është dalluar patetizmi në frymën e punëve të tij, por kurdo një frymë shumë e madhe pajtimi dhe nderimi, futur në dualitetin e bukur të formë-përmbajtjes.

I tillë ka qenë dhe në prezantimin e fundit të "Nëntori" me kulturën e spika-



tur por edhe mesazhin e bukur për Skënderbeun. Stefos i bën nder pikturës shqiptare dhe rajonale me frymën që përcjell, por edhe elementët e bukur dhe inovativë që kërkon...Urojmë ta kemi më shpesh...

Vizatimi me krahët është botuar dhe të "Poeteka" dhe është koleksion i Arian Lekës, kurse vizatimi i dytë është realizuar për "Nëntorin"...



tme dhe këtë e bëjnë individë me personalitet të lartë, që vetëdijën e tyre e vendosin në interes të shoqërisë për të emancipuar.

Cili nga artistët shqiptarë, megjithë përpjekjet e pakta që nuk mungojnë, mundohet t'i thërrasë shoqërisë, pa u përfshirë në politikë? Kush mundohet që artin e vet ta vendosë në funksion të ndriçimit të shoqërisë, pa futur në mes koeficientët politikë? Megjithë dëshirën e mirë dhe çfarë flasin nëpër emisione, ku më shumë nxjerrin kamjen dhe njojnë e tyre, shumë nga artistët tanë thjesht ia bëjnë me sy politikës. Për fat

të keq, arti ynë nuk e ndihmon vendin sepse më shumë individ-artist do të duket sesa t'i shërbejë ushqimit estetik të shoqërisë. Shqipëria (lexo politikanët), nga ana tjetër, e tregon respektin ndaj artit me egërsinë e saj, por edhe varfërinë e madhe ku e ka lënë artistin e zakonshëm shteti shqiptar. Pakkush e do ushqimin shpirtëror të këtij vendi, atë që frymëzon dhe ndryshon, sepse pakkush do të ndryshojë realisht Shqipërinë. Arti ynë ka mbetur jetim në një shoqëri të mbushur me helm dhe plot agresivitet. (Milosao)

R

REVIEW

Kam shkruar me entuziazëm disa herë për pikturën e Gazmendit, sepse më rrëmben filozofia e tij, forma e atypëratyshme, tejet personale e raportit të krijuesit me krijimin, më tutje e raportit të tij me kozmosin, mitin, paramendimin, zanafilloren, hyjnoren, simbologjinë, fuqinë katarsike, të përshpirtshme të artit sa dhe demoniake, ku rendi, harmonia, totaliteti kërkeshen po aty me shturjen, kaosin, copëzimin, zhbërjen, na shtron argumentin e tij kritikë Papagjoni

BARTËS DHE I BARTUR

- vepra dhe procesi krijues

NGA JOSIF PAPAGJONI

Të lutesh, përveçse një rit nisur mbase në zanafillë të njerëzimit nëpër shpellat prehistorike, është dhe një pastrim i vetvetes apo një bashkëshoqërim me tjetrin, për të ndarë vuajtjen dhe për të blatur paqen. Piktori i mirënjohur Gazmend Leka sjell një seri veprash që i kushtohen këtij akti heshtan, përjashtimisht vetanak, kredhur në një botë pa caqe, efemere, si e shpërbërë, apo e tejdukshme, apo e përtëjme, ku humbasin caqet, format, realitetet e prekshme, ku hapësirat vizualisht të rrokshme kthehen në shenja, përjetime, dritësime, kryqe, varre, tempuj, muzikë dhe heshtje - Heshtja e Madhe - mu atje ku nis HIÇI i madh, si i zhbërdhulët, një Dritë-Terr mes të zezës dhe të bardhës. Një ndërkomunikim. Atje ku artisti, prijtar dhe i vetë ndëshkuar, bartës i një vuajtje pa emër, ndofta të "ëmbël", ndofta të hidhur, një ekzorçisti vetvetes por në tjetër domethënie, i të mirës dhe i të bukurës, që kërkon të gjejë një vend diku, gjithsesi.

Kam shkruar me entuziazëm disa herë për pikturën e Gazmendit, sepse më rrëmben filozofia e tij, forma e atypëratyshme, tejet personale e raportit të krijuesit me krijimin, më tutje e raportit të tij me kozmosin, mitin, paramendimin, zanafilloren, hyjnoren, simbologjinë, fuqinë katarsike, të përshpirtshme të artit sa dhe demoniake, ku rendi, harmonia, totaliteti kërkeshen po aty me shturjen, kaosin, copëzimin, zhbërjen. A është procesi i krijimit, para se vepra e artit të sublimohet, një diçka e tillë, ose e ngjashme atypari? Pse vepra është një realitet absolut, i përcaktuar rreptësisht, i "ngjirë" në gjendjen e saj të fundme, e pandryshueshme më, ndërsa procesi paraprak është i gjithi relativ, i papërcaktuar, shpesh konfuz, i ndryshueshëm saora, pa fund e majë, një ecejake e mundimshme drejt fundit të tunelit, ku shfaqet befasi drita shpëtimtare? Kjo pyetje dhe ky mundim për t'i dhënë një përgjigje është ajo çka ekspozita e fundit "Lutja" e G. Lekës na fton të gjejmë e japim, sidoqoftë, një përgjigje. Por ato, pyetja dhe mundimi vetjak i piktorit, nuk janë vetëm të tija, por edhe tonat: janë alternativa estetike që lidhen me kuptimin e veprës dhe të procesit krijues.

Ekspozitat e mëhershme të Gazmend Lekës "Black Box", "Kutia e Zezë e Qenies", "Simbolon", "Molla", "Natura morta", "Taso" kanë qenë një rrugëtim mes shiut dhe zhegut, përpëlites dhe kthjellësisë, për t'u dhënë kuptim disa gjendjeve e përjetimeve tejet të thella të artistit, rrjedhimisht për t'u dhënë gjuhën piktorike vetjake gjësëndeve që e kanë rrethuar atë në ndërkohë qysh nga viti 1994, asoherë kur ia nisi këtij stili e kësaj paradigme piktorike, të cilat e kanë turbulluar, habitur, hutuar, lodhur, mrekulluar, frymëzuar, lumturuar. Sepse arti është vuajtje dhe lumturi njëherazi. Ekspozita e fundit me titullin "Lutja", me 24 veprat e saj, kompozime që kanë të gjitha së toku një nord tematik, ani pse e fundit për nga radha, është vijim i të tjerave, i kërkimeve të pareshtura të



Gazmend Leka

piktorit nëpër shenja e kode, qoftë në stil, qoftë në befasinë që sjellin, qoftë sidomos në risinë dhe atë ndjenjë konstante që Leka ka, për të dialoguar me të panjohurat, me "sfinksin" e laboratorit të tij krijues që diku në qoshe e studios së tij rri serbes dhe i nënqesh. Në këtë rast, pra, me semantikën krijimit si të tillë. Më ka lënë mbresë një mendim i tij, që lidhet me filozofinë e artit: "Duket se artisti krijon Gjithçka nga Hiçi, pasi krijimin vërtet e paraprin Heshtja e Madhe. E gjatë sa një fragment sekonde, apo sa një përjetësi, artisti dhe objektet që e rrethojnë, humbasin gravitet. Ato ngrihen nga dimensionit tokësor, për t'u rigjetur në një nivel të ri metafizik, ku marrëdhënia me hapësirën dhe hyjnoren, ngjzen përfundimisht ndryshe."

Lutja është një pëshpërimë e shpirtit, ndofta dhe pa i përpjekur buzët, me sytë e drejtuar në një ikonë, në një imazh të ngulitur religjioz. Apo askund, veçse në zbrastinë e mendjes, në nevojën për t'u mbështetur, për të gjetur një dytës, një vëlla, një motër, një mik, një shok. Një kallauz. Nevoja për t'u lutur herë është një klithmë e ardhur nga shumë thellë për një faj të rëndë të kryer herët a së fundmi, herë një pendesë e qetë, e pabëzajit, si e brishtë dhe herë të tjera si nevojë për

të rigjetur veten e humbur e bredharake në shpëstjellimet e mendjes dhe të zemrës. Gazmend Leka e ngjason veten me murgjit e dikurshëm manastireve tekta pikturonin ikonat, madje më thellë, me ata priftërinjtë e shpellave dhe shamanët që pikturonin shenja, numra dhe figura të përthyera, turr në metafora e simbole, për të mbërritur atje ku e zakonshma bëhej e jashtëzakonshme dhe e rëndomta sublimë. Ai provon të bëhet pra një prift ikonograf, por jo i një kohe, por i tërëkohshëm. Sepse ai rreket të shkrijë kohët, të shkruarë dhe të sotmen. Arti është një tjetër "religion", ndërsa piktura një tjetër "ikonë". Ikona, dmth arti, vepra e re, është në kokën e tij, porse sipas tij i duhet heshtja, përqendrimi maksimal, përhumbja, arratisja prej vetes për të rimbërritur po te vetja, por me tjetër brendi. Kjo është mbresa e përgjithshme që unë përthitha nga seria kompozicionale prej 24 tablosh e ekspozitës së tij.

...Kur lutesh je me veten dhe me atë Tjetrin: dikush e quan Zot, dikush e hamendëson si një pushtet absolut, të përtejme, dikush tjetër sendërgjon diçka mes qenies dhe joqenies. Kur lutja bëhet rit, ti hyn në besim, i vjetër a i ri qoftë ai, s'ka rëndësi. Kur lutja vjen si cast i pakthyeshëm dhe i papërsëritshëm i një gjendjeje shpirtërore ndërë-

shas, kur ti kërkon një zgjidhje e ajo mënon, kur ti eposh drejt një fundi e ai tëholllohet, kur ti prirësh kah një siluete, ravijëzimi a konturi diku dhe ato që të gjitha gëlltiten mes territ, atëbotëti ke mbetur veçse te vetvetja, jo në religion. Mirëpo përfytyrimi yt, sakaq, është tejngopur me ikona, rite, rrëfenja, shkrime të shenja, mrekulli, zota (fitomorfe, zomorfe apo atropomorfe), gjer te fetë monoteiste. Kësodore ti përzien fenë me qenësinë tënde jofetare, religionin me ontologjinë e vetëqenies, tanimë ndofta si "realitet filozofik". Leka e quan veten një "prift", në fakt është veçse artisti brenda "varrit" të vet të krijimit, për të dalë që andej si një Kostandin dhe për të sjellë tek e ëma - shikuesi - krijimin e "mërguar" larg, 9 male kapuar (9 rrrathë të ferrit agnostik), Doruntinën e hijshme, BUKURINË. Pra, me dy fjale - Artisti në praglindje - kur nga vdekja lind jeta, nga heshtja lindin zëra, nga e pathëna lind domethënia: tabloja piktorike. Ja, në këto pandehma më çonte koncepti i ekspozitës "Lutja", njëmendësuar në një mori kompozimesh ku "heroi" ishte po vetë ai, Gazmend Leka, i trupëzuar në gjeste, pamje e pozicione të ndryshme, gjegjësisht kompozimit dhe idesë përshkuese. Kokëulur, me shpinën dhe flokët e stërpikur nga e verdhja e pruaruar ëngjëllore, ja ku poshtë, në tavolinë, spikatini penelat, një vizore. Çfarë të bëj? A t'i marr këta penela, a ta përziejë këtë bojë? Por çfarë do të pikturoj? Ah jo, ai s'e di, ende s'e di. Jam i turbullt, pëshpërit ai. Imazhi ende s'ka mbërritur... Pastaj ja ku në tablonë tjetër, koka e tij na shfaqet e mbështetur pafuqishëm, kredhur në humbëtrë, në dërrasën pas telajos... Më tej fytyra e tij e muqëtar, symbyllur. Po fle vallë? Ka vdekur si një Krisht mbi kryq, për t'u ringjallur nga FRYMA? Apo thjesht mbyll sytë që errësira të bëhet totale e në thellësi të saj të shkrep një shkëndijë, fillesa e krijimit?... Nga fytyra, tanimë imazhi përfshin gjysmën e trupit lakurij, si në një morg a procesion mortor, po njësoj ngjashëm me Jezu Krishtin: flijimi dhe ringjallja e mëpastajme. Këtu ngjyra e mishit (jeta) dhe gërricjet e dritës gjithandej, si rrezatime dhe ardhje vegimesh nga sipër, e bëjnë tablonë edhe më impresioniste... Pastaj vjen tabloja tjetër, ku ai është i shtrirë barkas, i veshur, rishtazi i rrethuar nga penelat, bojërat, kutiçka e gjithfarë gjësëndesh, në një rrëmujë totale, me këpucët e zbatuara, si ata asketit a besimtarët që shkojnë në tempull për falje...

Por piktori i rrëshqet nocionin "lutje" si të tillë, pra si rit me mbivendosje religjioze. Ai e zhvesh atë nga kjo brendi e drejtpërdrejtë, e shtëmëng duke e rifutur në një tjetër formë e paracaktim, tashmë mirëfilli estetik e artistik: aktin e krijimit si të tillë. Më saktë, parapërgatitjen e aktit të krijimit artistik si një flijim (vdekje) e gjendjes inerte dhe ringjallje (rijetësim) e gjendjes aktive. Palëvizshmërinë në lëvizshmëri. Arti, në fund të fundit, është një rithemelim: nga materialja drejt shpirtërores, nga e drejtpërdrejtja drejt tërthortës. Andaj dhe ai shfaqet si një midis (e ndërmjeme), si "natyrë e dytë", mes

Ekspozitat e tij

Ekspozitat e mëhershme të Gazmend Lekës "Black Box", "Kutia e Zezë e Qenies", "Simbolon", "Molla", "Natura morta", "Taso" kanë qenë një rrugëtim mes shiut dhe zhegut, përpëlites dhe kthjellësisë, për t'u dhënë kuptim disa gjendjeve e përjetimeve tejet të thella të artistit, rrjedhimisht për t'u dhënë gjuhën piktorike vetjake gjësëndeve që e kanë rrethuar atë në ndërkohë qysh nga viti 1994, asoherë kur ia nisi këtij stili e kësaj paradigme piktorike, të cilat e kanë turbulluar, habitur, hutuar, lodhur, mrekulluar, frymëzuar, lumturuar

CMM


Grafisti Arben Meksi meriton një tjetër çmim ndërkombëtar në karikaturë, në Konkursin Ndërkombëtar të zhvilluar në Krushevac (Serbi). Në këtë aktivitet morën pjesë më shumë se 270 karikaturistë, me plot 600 punime nga 48 vende të ndryshme të botës.

Karikatura shqiptare merr një nga tre çmimet e Serbisë

Arben Meksi nuk ka zhgënjyer sërish. Në Konkursin Ndërkombëtar të zhvilluar "Relation" dhe zhvilluar në Krushevac (Serbi), ai është përshfaqur në një nga tre punët kryesore. Në këtë aktivitet morën pjesë më shumë se 270 karikaturistë, me plot 600 punime nga 48 vende të ndryshme të botës, ku Juria nuk ka hezituar shumë për të.

I jashtëzakonshëm është Arben Meksi në abstragimin e tij, ku tema me peshkun dhe grepin, e zgjedhur enkas për këtë përfaqësim, jepet përmes metaforës që i vendos të dy subjektet në pozicion bashkëbisedimi. Karikatura u vlerësua për mesazhin dhe grafikën, që Meksi i zgjidh me skrupulozitetin e vet, që lidhet me formimin, por edhe mënyrën e punës që ka zgjedhur.

Arben Meksi është lehtësisht i dalueshëm kur është fjala për t'iu afruar një teme të caktuar. Si një intelektual i plotësuar mundohet që abstragimi mos ta përfshijë lexuesin në hulli të padalshme. Ndjek me thjeshtësi një ide dhe atë e zbrërthen me kanonet e karikaturës, por me një cinizëm tipik intelektual, ku ironia, pakënaqësia nuk lënë pas zgjidhjen grafike dhe respektin e kategorive të estetikës.



të gjallës dhe të vdekurës, të njemendës dhe iluzives, reales dhe të përfytyruarës. Për këtë shkak, për ta bërë sa më intim e vetjak këtë akt specifik të genies, siç është përnjëmend akti i krijimit artistik, kur genia shpërndërohet dhe riederhet në një tjetër trajtë, ku ajo konvertohet në ART, Gazmend Leka e kthen trupin e tij në imazh, në situatë, në subjekt dhe në kumt të vetë procesit të krijimit. Ja, shiheni atë! Trupi cullak i piktorit, i mbledhur kruspull, në pamundësi e vuajtje, i gjithi flu, si një njollë e madhe ende e patrajtë, përballë një letre të bardhë, si përballë një pretence: Dënim apo falje, jetë apo vdekje! A s'është vallë dhe vepra e artit po njësoj: dëshitim ose sukses, errësim ose shpërndritje, dëshpërese ose ngazëllyese?!



Në kërkim të artit ti ose e gjen atë, ose e humbet. Leka e kthen këtë proces mendor në një figurë vizuale fizike të identifikuar me vetë trupin e tij, i cili ka atributet e metaforës. Dhe ngjan kësodore sikur arti bëhet art, pra "Arti në Art". Por s'është aspak kështu, se arti i Lekës, në këtë rast, nuk është shpengimi, as arti i kthyer në qëllim më vete, pa ide, pa shqetësim. Përkundrazi ai ka premisë, shtyqës dhe qëllim që të shpjegojë diçka nga misteri i krijimit. Kësodore objekti i artit nuk është më larg, as jashtë atij, por brenda, dhe me atë. Ose është ai vetë Arti, vepra dhe artistit, subjekti dhe objekti, një dihotomi që humbet kufijtë, shkrirhet, njëjtësohet. Ky proces estetikisht është i njohur, bie fjala, me autoportretet. Por në rastin e ekspozitës së G. Lekës nuk bëhet fjalë për një grumbullim e numërim autoportretesh, goftë dhe në këndvështrime e forma të ndryshme. Përkundrazi, bëhet fjalë për një konceptim ku fytyra dhe trupi i piktorit shndërrohen në personazh-bartës të idesë së Lutjes dhe Rimishërimit. Nga genie ai bëhet, si të thuash, "mosgenie"; bëhet figurë, ide, konfigurim i një mesazhi që krijon kohezion në një sërënditje trup-fytyrash të piktorit të kthyer në personazh... Ja tek shtang përpara një tabloje domethënëse: trupi i lakuriqtë i piktorit i kthyer përmbyja, rrethuar nga bojërat, kavaletit, dyshemeja vertikale si mur ngujimi a murimi. Krijimi lipset të përlindet si një lakuriqësi e shpirtit. Kjo për mua është një gjetje estetikisht e bukur, e guximshme, sfiduese, madje tronditëse... Ja dhe një tjetër, sërish lakuriq, por

si në arkëmort, vertikalisht, rrethuar nga dhjetëra penela dhe kuti boje të shpërndara nëpër shesh në mënyrë të çrregullt, për të gjetur një pikë ekuilibri, por ajo ende s'ka ardhur (Më jepni një pikë mbështetëse që të përmbys botën! - pat thënë dikur Arkimedi)...

Konceptimi i rritit të lutjes është thaujse liturgjik dhe figura e personazhit të G. Lekës sepse ngjason bash si ata murgjit e kishave dhe manastireve që luten e përfalen para ikonave, për kuptimin e porosive të shenjta dhe transhendentale. Në fakt akti i krijimit artistik është trashedental. Është një farë ribërje e botës së mendjes dhe ndjeshmërisë së shpirtit drejt një eskatologjie, që vetëm fuqia e artit e mbërrin dhe e projektton. Arti është thaujse edhe një krezim, një kungim. Në një nga tablotë e kësaj serie piktori na shfaqet jo vetëm, por me një tjetër, ndofta një berber, teksa ai i shërben, e rregullon, i qeth mjekrën "prej priftit", përpara "Lutjes". Dhe këtu indirekt vjen në konceptin estetik të katarsisit, pastrimit, tashmë jo të shikuesit, por të vetë artistit si medium midis inspirimit që zbrzet nga sipër me atë që e përcepton veprën e mëpastajme.

Piktori Gazmend Leka në 24 tablotë e tij në këtë ekspozitë tematike është fizikisht i rrokshëm, ani pse herë-herë ai e bën portretin dhe trupin si të turbullt, efemer, të hapërdarë, ku prekja e lëkurës thaujse humbet. Ndofta kjo është e qëllimtë për të thënë se shumëçka në veprën e artit nuk është tërësisht e qartë, ka dhe muguëtira, ka dhe brendakalime, shpërndërime. Përballë sipërfaqes së bardhë të telajos para krijimit, artisti gjendet si gruaja shtazënë para dorashkave dhe bluzës së bardhë të gjinekologut. Pjella nuk duhet të vritet, të dështojë. As të dëmtohet. Andaj ai lutet që koka dhe zemra e mbaruar të lind krijimin e ri, siç çdo grua lutet që fëmija i saj të lind i shëndetshëm. Nuk lind vetëm ajo që është brenda genies, por sikur lind edhe vetë piktori si njeri, sepse krijimi është një proces çlirim. Telaço, bojërat, penelat, tavoloci, siç i shohim në njëër nga tablotë, janë mjetet e krijimit, si duart dhe instrumentet e mjekut gjinekolog, të cilat mundësojnë Lindjen e veprës së artit. A si herë ajo çka është brenda piktorit del jashtë tij, bëhet e të tjerëve. Po a është vallë e gjitha e kuptueshme për të "tjerët", apo ka mbetur përjashtimisht brenda genies së tij, nganjëherë edhe prej atij e pa shpjeguar dot?! Dhe këtu piktori zbulon çastin mistik të krijimit. Po, akti krijues është diçka përtej vetë piktorit dhe aftësisë së tij të shpjegimit, andej dhe prej këndej ka dalë koncepti i frymëzimit vertikal nga Lart. Artisti s'është veçse një bartës dhe përcjellës i Frymës. Edhe ky koncept estetik është tejet i njohur. Gazmend Leka nuk na e thotë drejtpërdrejt, por jo pak tregues të pikturave të tij në këtë seri sikur e ungjillizojnë krijimin si të tillë, ligjërojnë pamundësinë e shpjegimit të tij... Tani ja kam ngulur sytë një tjetër tabloje: figurës së artistit të përgjuron në dyshenë e studios si në lutje, përballë kompozimit të ri ende pa formë (si priftërinjë ikonografë qëmotit përpara ikonës, me luten për zbritjen e Frymës brenda shpirtit të tyre). Përballë ravijëzohen genie gjysmë antropomorfe të mitizuar, genie si ëngjëj të zinj me krahe a fytyra maskash, që truri prodhon në terrin e përsiatjes dhe

përqendrimit. Dhe një shi i bardhë që e rreh nga sipër-djathtas piktorin e kërrusur në lutje...

Studioja e artistit merr atributet e një laboratorit a mitre ku pllenohet krijesa e re. Është një farë kisha e tempulli, dhe brenda tij fytyra e përshpirtshme e një prifti, a magu, a shamani, që është vetë artisti G. Leka si piktor në atributet e dyfishta: bartës dhe i bartur. Pra, bartës i një fare të re që tashmë ka mbirë në trurin e tij, thellë genies krijuese, ende e paformë, ende e papërcaktuar qartë, dhe që është vepra e ardhshme në proces trajtësimi e zhvillimi. Dhe, nga ana tjetër, i bartur. Po prej kujt, prej nga, prej kur, prej çfarë? Këto janë pyetje që humbin shpesh në misterin e krijimit, ku tingujt misteriozë brenda heshqes sublime të mendimit, të vetë genies estetikë të piktorit, në prag shpëpërtjes dhe lidhshes spirituale me të përtejshmen, bien si kambana kumtesh që veçe ai mund t'i dëgjojë, t'i dedokojë, t'i shkruajë më në fund në një pentagram të vështirë, që është vetë piktura. Kësodore "kisha" e krijimit shfaqet si genia e piktorit, si shpirti i tij, mendja e tij, në qetësinë absolute kur gjithçka përqëndrohet në një pikë inkandeshtente dhe krijon prej atij një fokus drite: imazhin e veprës që po lind.

Nuk do t'i mbyllja më bukur dhe në mënyrë më të kthjellët këto mbresa të miat pa fjalët e mënçura të vetë piktorit Gazmend Leka, që ndofta janë shpjegimi më i mirë: "Kjo ekspozitë i dedikohet Heshqës së Madhe. Aty, si në një manifest artistik, pësha e arsyes dhe trupi i artistit, përumben në një perspektivë personale, ndërkohë që studioja kthehet në tempullin e tij vetjak. Ai është aty, i vetëm, me personazhet reale dhe irrealë, me miq e demonë, erën e vajit të linit dhe tingujt e muzikës. Mes rrëmujës së përherëshme, ato ngatërrohen e përzihen njëra me tjetrën. Në mes të kësaj rrëmujë, i përlurur, fanitet imazhi i tij, që endet i vetmur në studio, i përdjekur shpesh nga imazhi i fundmë i një varri fantazmë, apo nga një hije-krqy i "rastësishtëm", gjithë-përshirë në një dimension shpirtëror të thellë, tërësisht i zhveshur nga çdo gjë materiale, si në një rit shamaniq, ku qiellorja dhe tokësorja bëhen njësh".

Nga Josif Papagjoni

E

EKSPOZITA

NGA EDISON ÇERAJ

Kjo është një nga ato pyetje që në thelb nuk ka nevojë për përgjigje, pasi të gjithë e dinë, ose të gjithë e kanë "të qartë" brenda vetes. Gjithsesi nuk është as një pyetje thjesht retorike. Pyetje të kësaj natyre i ngjajnë asaj dilemës mbi kohën që trajton Shën Agustini, ku thotë se nëse nuk më pyesni se ç'është koha, e di përgjigjen; por, nëse më pyesni, atëherë nuk e di.

Megjithëse është një dilemë që i referohet qartazi përvojës së secilit nga ne (e shkuara dhe ëndrrat), është po aq e qartë se përvoja nuk na vyen, ose nuk është e mjaftueshme për të zgjidhur "enigmën".

Le të bëjmë një ndarje ndërmjet të shkuarës në rrafsh individual (kujtimet) dhe të shkuarës në rrafsh shoqëror (historia). Për sa i takon të shkuarës individuale, kur ajo bëhet e tillë, ne nuk e ndryshojmë dot: as nuk mund t'i heqim e as nuk mund t'i shtojmë gjë. E njëjta gjë vlen edhe për ëndrrat.

Ndërsa e shkuara në rrafsh shoqëror, me të cilën merret historia, natyrisht që është e ekspozuar ndaj ndryshimeve, gjë që është provuar e vazhdon të provohet në qindra raste, për shkak të pushtetit të pamatit që ajo ushtron. "Ai që kontrollon të shkuarën, kontrollon të ardhmen. Ai që kontrollon të tashmen, kontrollon të shkuarën." (Orëll)

Ndaj dhe thuhet se historinë e bën fituesi. Një rast tipik për këtë është historiografia komuniste, që është fund e krye ideologjike, dhe duke qenë e tillë nisat nga premissa se faktet historike duhet të jenë në përputhje me ideologjinë, përndryshe janë të padobishme, madje të rrezikshme. Ja pse kemi fabrikime të llojit "historia zyrtare", e këtij apo e atij vendi.

Pikërisht për këtë arsye, në ato vende ku ka vepruar një ideologji e tillë, janë të rëndësishme kujtimet/memualet vetjake, duke shënuar kështu një ndryshim të qenësishëm ndërmjet historisë dhe kujtesës. Historia mund të jetë dhe "duhet" të jetë kolektive/shoqërore, ndërsa kujtesa mund të jetë e tillë vetëm për aq sa është individuale.

I tillë është rasti edhe me veprat e fundit të Majlinda Kelmendit: ajo mjaftohet duke gjurmuar kujtesën vetjake, duke tejkaluar kështu historinë zyrtare, atë që është certifikuar nga institucionet.

Për Kelmendin të kujtuarit dhe të ëndërruarit janë dy gjendje të lidhura ngusht me njëra-tjetrën. Sidomos në rastin e pikturave, të cilat nuk mund t'i klasifikojmë si abstrakte apo si jofigurative, akti i të kujtuarit sublimohet me disa shenja që pluskoin ndërmjet të vetëdijshmes dhe të pavetëdijshmes. Kur autorja e çon deri "në fund" aktin piktorik mbi një shenjë të caktuar, atëherë kemi të bëjmë me një lloj vetëdijshme; ndërsa kur mjaftohet me pak prekje, kur ngurron ta identifikojë, atëherë shfaqet e pavetëdijshme me stilitë e saj të errëta, mbi të cilat mund të hedhë

Të martën më 5 mars 2019 në Galerinë Kombëtare të Kosovës u çel ekspozita personale e artistes Majlinda Kelmendi, ekspozitë, e cila do qëndrojë e hapur deri më 5 prill 2019. Ekspozita mban titullin: A është e shkuara ëndërr? dhe përmban vepra artistike multimediale, instalacion, video-art, pikturë, etj., punime që janë të paekspozuara dhe të punuara vitet e fundit.



Kjo ekspozitë është kuruar nga Edison Çeraj & B17 Architects

Cili është ndryshimi mes të shkuarës dhe ëndrrave?

Bota nuk ka nevojë për atë artist që e paraqet realitetin siç është. (Marina Abramoviç)



Majlinda Kelmendi

dritë vetëm e ardhmja.

Nga ana tjetër, të këto piktura hasim edhe një marrëdhënie intensive ndërmjet ndjenjës dhe mendimit, ku ndjenja ngacmon mendimin dhe mendimi nuk e përjashton ndjenjen. Është një harmoni e fshehur "mes rreshtave", e cila i përshkon si një fllad temjani të gjitha veprat e këtij cikli.

"Bota është një komedi për ata që mendojnë dhe një tragedië për ata që ndiejnë," thoshte Horace Walpole

- domethënë: bota na genka një dramë, duke qenë se nuk ka njeri në botë që vetëm mendon apo vetëm ndien, por herë i jepet një pjesë gjendje e herë tjetër. Në thelb kjo ndodh pa vullnetin tonë: thjesht jepemi pas një rës ose pas tjetrës. Ashtu siç nuk zgjedhim se çfarë kujtojmë e çfarë harrojmë, po ashtu nuk zgjedhim se kur do mendojmë e kur do ndiejmë. E gjitha rrjedh. Vetëm rrjedh. Ne dorëzohemi. Pastaj ngrihemi. Më pas zgjedhim. Pastaj harrohem. Më

A ËSHTË E SHKUARA ËNDRËR? SIMBOLIKË KRYQËZUESE...

Pa ndërgjegjen nuk do ekzistonim.

Mbi të gjitha jeta është një luftë e vërtetë për të tejkaluar përballuar situata të ndryshme dhe falë tyre ne krijojmë identitetin tonë, ne kulmin e zinxhirit ushqyes. Vetpërqëndrimi është një produkt përcaktues i karakterit të punës së artistit.

Lindim të ndryshëm.

Vetëbesimi është destinacioni që nuk mund t'i shmangemi, arsye e cila transformon personalitetin tonë në një luftë të vazhdueshme me pengesa.

Quket e rëndësishme që të çlirohemi nga modele të tiposura që na shterojnë atë çfarë kemi të veçantë prej një projektimi inteligjent... Përbërja e këtij subjekti është i thyer i analizuar dhe i rimontuar, duke afruar kohërat e largëta për të na bërë të kuptojmë dhe të mbajmë pranë qindra rrugë të ndryshme të mendjes të arsyetuara me pretendimin dhe nevojat që përgjithmonë të kërkojmë rrugë të reja.

Lidhja e emocionit me rregullin, duke mbledhur leksionet e mëdha të së kaluarës, është brenda vetvetes simbolike krqëzuese

Majlinda Kelmendi

...ku është dëshmitari?

Sepse unë s'kuptoj ku ndryshon realiteti nga mashtrimi. (Tomas Venclova)

pas kujtohem, me shpresën që të mos jetë vonë. Edhe kur është vonë, ka gjithmonë një xhep kohë për të bërë atë që duhet. Është ai xhep kohë që të rikthen të gjithë "kohën e humbur".

Kelmendi e kërkon me ngulm këtë "kohë të humbur", atë kohë të ndaluar ku lejohej vetëm ajo që diktonte "vija e partisë". Ajo kërkon gjurmët e saj të humbura në atë periudhë, si dhe gjurmët e asaj periudhe në të tashmen e saj, në atë çfarë ajo është sot jo vetëm si artiste, por mbi të gjitha si njeri. Këtë kërkim e ndëshim edhe të dy video-instalacionet: Error dhe eëe.info.com, ku i pari na kujton se ka një error të përjetshëm që vjen si dikat drejt nesh, duke u shfaqur në forma të ndryshme, ama me të njëjtin thelb: për të na "korrigjuar".

Ndërsa i dyti, me një titull që evokon disa simbole tipike të kësaj kohe, qëndëron raportin tonë me të dhënat/informacionin, ku nën trynë për të qenë të informuar, pa e vënë re aspak ne kemi cenuar ndjeshëm raportin tonë me mendimin dhe sidomos me kujtesën.

Për t'u rikthyer të marrëdhënia mes ndjenjës dhe mendimit, duhet thënë se ne përballemi çdo ditë me optimizmin e pakompromit të progresistëve dhe me pesimizmin e mistikëve. Të parët e mbajnë shikimin poshtë, të dytët lart. Të parët duan të arratisen nga e shkuara, madje edhe nga e tashmja, të dytët gjakojnë të arratisen nga një e ardhme që konceptohet si një "jetë pa dhimbje".

Disa shpallin fundin e botës, disa të tjerë trumbetojnë "rendin e ri".

Ngjan sikur ngushëllimi më i madh është se asgjë nuk është e sigurt, se asgjë nuk mund të pohohet apo të mohohet me siguri të plotë. Kjo lloj pasigurie, që përputhet me natyrën e pamundur dhe të papërsosur të qenies-në-botë, ka të mirat e veta, sepse na mban zgjuar, si një

antidot kundër shkujdesjes apo klapisë. Një e mirë tjetër është se na bën më kërkues, duke u maturuar kështu kundrejt çdo rrethë qe na prek drejtpërdrejt apo tërthorazi. Po ashtu, ndomëse në pamje të parë pasiguria shfaqet si e kundërta e bindjes, në fakt, ajo mund ta forcojë një bindje të caktuar përmes "krizës" që të shkakton, ose mund të nxjerrë në pah pavërtetësinë e saj.

Nevoja organike se si të jetojmë sendërtun një marrëdhënie të mirë me harresën; kurse nevoja e ontologjike se pse jetojmë bën po të njëjtën gjë me kujtesën. Por, kjo është e mundur vetëm nëse me këtyre dy nevoja themelore - që shfaqen në mijëra forma - ekziston një lloj harmonie/ekuilibri, sepse në të kundërt ka vetëm teprim, herë me njërin e herë me tjetrën.

Jo vetëm në botën e artit, por edhe në jetë qëllon të përballemi me personazhe të "lumtur" për shkak të harresës ose "të pikëlluar" për shkak të kujtesës.

Majlinda nuk i rikthehet të shkuarës ngaqë është e magjepsur prej saj, as për t'u arratisur prej të tashmes, por, mbi të gjitha, për të njohur veten dhe për të kuptuar kohën në të cilën jeton. Arti është një mundësi e llojit të vet për ta bërë këtë.

Kështu, kjo përpjekje nga ana e saj na kujton se njeriu mbetet ajo çfarë ndien dhe mendon, pasi realizimi praktik i një ndjenje apo mendimi është gjithnjë i mangët si pasojë e kufizimit në kohë dhe hapësirë.

Shënime

Në të gjitha vendet me një të kaluar totalitare, ka një "bum" të madh botimesh me natyrë memuaristike, dhe një prej arsyeve të këtij fenomeni është edhe nevoja e etshme e shumë njerëzve për t'i rrëfyer gjërat "siç kanë qenë", dhe jo sipas "versionit zyrtar".


Opinioni / i Ditës

Nga Shqipëria: asgjë e re nga lufta virtuale civile

Nga Fatos Çoçoli

(vijon nga faqja 1)

... shumë të shtenave, madje edhe tanke nëpër rrugë(!). Nga toni i zërit të tij dhe fjalët alarmante të dukej se po transmetonte drejtpërsëdrejti një gazetar i CNN nga Beirut i djegur dhe i martirizuar i 14 viteve më parë. Sigurisht që gazetari i RAI-t mori një shtesë të majme mbi rrogën si korrespondent, nga "fakti" që po punonte në një vend në gjendje lufte civile. Pasi "lufta civile" u shua brenda disa orëve në Tiranë, nuk besoj se dikush nga drejtuesit e stacionit televiziv e ka vënë përpara përgjegjësisë gazetarin pse e bëri qimen tra. Thjesht vlerësuan "scoop-in(lajmin e bujshëm" nga një vend i paqëndrueshëm dhe pjellë e trazirave si Shqipëria(sipas tyre). Këto ditë të protestave(disa edhe të dhunshme) të opozitës sonë të vetëmërguar nga Parlamenti, gazetarë të tjerë italianë të rrjeteve televizive apo të përditshmeve raportuan protestat, gati me të njëjtin ton dhe fjalë alarmante si sivëlai i tyre i 21 viteve më parë. Në gjuatje të lajmit të bujshëm dhe tronditës në një reportazhi prej një vendi në prag të luftës civile. Kjo mund të jetë dëfryese për pseudogazetarë në gjueti të dëshpëruar të lajmeve sensacionale (madje janë gati edhe thaujse t'i shpikin ato), por është mizore për pamjen e një vendi të varfër, me natyrë të bukur dhe njerëz të dashur e bujarë, që po provon të rritet. Edhe pse Italia këtë vit mund të hyjë në mosrritje (stanjacion) ekonomik dhe jo pak sipërmarrës të vegjël italianë, sidomos nga Italia e Jugut po e mendojnë një investim në vendin e shqipeve (jetojnë mbi 20 mijë italianë në Shqipëri, me ndërmarrjeve fason, qendrave të thirrjeve (call center) e shumë aktiviteteve të tjera të biznesit. Të flasësh sikur po flet nga Libani i 35 viteve më parë është të trembësh kot dhe largosh mundësinë që në Shqipëri të vijnë investues të tjerë të vegjël italianë dhe një kapital që vendit mund t'i rritet edhe me 75 milionë euro vetëm për këtë vit. Ky dem nuk është i pakët për një ekonomi të vogël si e jona. Nga ana tjetër, kjo trembje mund të ketë edhe efekt domino në investues të tjerë perëndimorë. Kryeministri bëri mirë që pranoi intervistat e shumta me gazetaret kryesorë italiane dhe daljen në një emision televiziv që ndiqet nga 12 milionë teleshikues në vendin fqinj. Pateria për prag konfliktit social dhe gati lufte civile në Shqipëri në këto ditë të fundit, që shpërtheu me disa damarëve të papërgjegjshëm të informacionit gazetaresk italian u për-



ball me dëshirën për zhvillim të qetë të një vendi mik të Italisë, e shprehur nga goja e kryeministrit të këtij vendi. Goditja përfundimtare poteres i erdhi nga protesta gati tërësisht paqësore e opozitës katër ditë më parë përpara Kuvendit. Kasandrat e gjëmës shqiptare u ndjenë keq. Por një popull i tërë u ndje mirë. Informacionin e devijuar për Shqipërinë dhe shqiptarët kanë mbi 27 vjet që po e ndjejnë emigrantët tanë në Itali dhe Greqi. Gjaj i

natyrshëm dhe i lehtë i mediave të vendeve tona fqinje janë bërë vetëm aktet e dhunës dhe krimet e bashkatdhetarëve tanë (sigurisht mes 1.2 milionë shqiptarëve që jetojnë në Greqi dhe Itali ka edhe disa qindra e madje mijëra kriminelë apo hajdutë). Shumë radhë, një në dhjetë njëmijë, janë rastet e veprave të mira dhe të lavdërueshme të emigrantëve tanë, që kanë rrokur vëmendjen e medias së vendeve fqinje. Situatë ka ndryshuar shumë këto vitet

e fundit, me përshtatjen e shpejtë dhe integrimin gradual të njerëzve tanë atje. Por prapë është shumë vështirë dhe mendësia e të qenit superiorë ndaj shqiptarëve, për fat të keq është e pranishme mes shumë grekëve dhe italianëve. Duke e kujtuar ende të folurit keq për Shqipërinë dhe shqiptarët si sport të preferuar kombëtar, disa media italiane bëjnë autogol përpara ndjekësve të tyre, pse askush nuk do ta bëjnë për bu-dalla. Italianët e thjeshtë e shohin dita-ditës se shqiptarëve mund t'u besohet dhe me ta mund të bashkëjtohet si me çdo evropian tjetër. Dhe poteren e shtirur të disa gazetave dhe televizioneve të tyre për gjoja rrëmujë totale dhe prag lufte në Shqipëri jo vetëm nuk e besojnë, por shprehen me njëri-tjetrit: "Ja këta, gjatë të sëmurrë të scoop-it(lajmit të bujshëm)". Ja përse një shkrim sarkastik i një blogjereje italiane dje titullohej: "Nga Shqipëria: asgjë e re nga lufta virtuale civile".

Pasi "lufta civile" u shua brenda disa orëve në Tiranë, nuk besoj se dikush nga drejtuesit e stacionit televiziv e ka vënë përpara përgjegjësisë gazetarin pse e bëri qimen tra. Thjesht vlerësuan "scoop-in(lajmin e bujshëm" nga një vend i paqëndrueshëm dhe pjellë e trazirave si Shqipëria(sipas tyre).

HOROSKOPI

DASHI
Të hysh në veprim sot është me shumë rëndësi. Progresi është gati të arrihet dhe mund ta gjeni veten në qendër të një aktiviteti të fuqishëm. Në sferën e dashurisë, do të merrni lajme të mira.

DEMI
Në punë mund të përballeni me xhelozitë. Mos u habisni, sepse në momentet më të suksesshme në karrierën tuaj do të dalë dikush që të përpiqet t'ju shkaktojë pengesa. Në dashuri, jo gjithçka po ju bën të lumtur.

BINJAKET
Sot pritet të merrni disa lajme të mira sa u përket financave. Një investim mund të sjellë të ardhura të mira. Në aspektin profesional, mund të rriteni në detyrë si rezultat i angazhimit tuaj të vazhdueshëm.

GAFORJA
Duhet të filloni t'i jepni vetes dashurinë që meritoni. Trajtojeni veten me ushqimin tuaj të preferuar. Nëse nuk e trajtoni veten me durata të papritura herë pas here, atëherë kush do e bëjë?

LUANI
Kur ka qenë hera e fundit që jeni argëtuar? Mund të tingëllojë si e palogjikshme, por ndonjëherë edhe argëtimi kërkon planifikim serioz dhe të hollësishtëm. Kur të gjitha detajet të shpalosen, do të ndihni të relaksuar në shoqërinë e njerëzve që doni.

VIRGJERESHA
Pa marrë parasysh se çfarë lloj ndjenjash negative keni ndaj një personi tjetër, sot ju do të duhet të faini dhe të harmoni, të paktën përkohësisht. Në mënyrë që diçka e rëndësishme të ndodhë, do të duhet të tregoni maturi.

PESHORJA
Edhe njerëzit shumë të mençur mund të bëjnë gjëra pa kuptim herë pas here. Nëse në një moment do të tregoheni më i çliruar se zakonisht, nuk ka asgjë të keqe. Thjesht do të çliroheni nga energjia negative.

AKREPI
Me pak para shtesë në xhepi, do të keni më shumë pranverë përpara. Paraja është gjithnjë e fuqishme, por tani ajo mund të ndikojë në gjendjen shpirtërore dhe jetën tuaj shumë më thellësisht se sa mendoni.

SHIGJETARI
Ju e dini se krijërat plotësojnë të ëmblat dhe se gjalpë plotëson çokollatën, por është gjithashtu e vërtetë se trishimi plotëson lumturinë. Pra, nëse nuk keni përjetuar shumë gëzim kohët e fundit, ngushëllohuni me faktin se kjo periudhë blu do të përfundojë së shpejti.

BRICJAPI
A keni parë një nga ato ëndrra në të cilat edhe pse përpigëni të largoheni me vrap, nuk lëvizni dot as gshinë e vogël? Nuk është e qartë se çfarë e pengon progresin tuaj, por identifikimi i këtyre pengesave do ju ndihmojë që të vini në zbatim taktika të reja.

UJORI
Mundohuni të kaloni më shumë kohë argëtuese me miqtë dhe familjen tuaj. Nuk do të jetë e vështirë të gëshet dashurinë tënde. Me pak talent do të arrini të zgjoni interesin e një personi.

PESHQIT
Fjalët tuaja do të kenë më shumë fuqi sesa zakonisht sot prandaj duhet të mendoheni shumë para se të flisni. Luani në mënyrë të sigurt dhe nëse nuk mund të thuash diçka të mirë, mos flisni fare.

Opinion *i* Ditës

Rama duhet ruajtur nga deliri?!

Nga Ben Andoni

(vijon nga faqja 1)

... të vetëm të lirë dhe inteligjent të ngrihet kundër. Cilët janë njerëzit që përbëjnë pjesën më të madhe të popullsisë - ata inteligjentë apo budallenjtë? Ky postulat është tërhequr nga "Armiku i Popullit" të dramaturgut të njohur Henrik Ibsen.

Në fakt, marrja e shumicës së vendeve në parlamentin shqiptar në zgjedhjet e fundit nga zoti Rama është përcjellë si një fitore absolute dhe si një revansh, mbi një opozitë krejt apatike dhe me vizione të cunguar. Për fatin e tij, me gabimet e pareshtura dhe me mungesën totale të një strukture qëndrimesh dhe qëllimi të opozitës, kryeministri Rama po lundron i qetë në pushtetin e vet, i cili po e deh gati në forma të pamenduara. Këtë e sheh nga leksiku dhe qëndrimi i tij, por edhe nga deklaratat e fryra, që i lënë vendin njëra-tjetrës.

Shqiptarët që mezi ranë rehat nga mbledhjet kilometrike të Ekzekutivit Berisha dhe qesëndive të tij, tashmë i janë dorëzuar një propagande, që ajo që bëhej dikur nga regjimi do të dukej krejt e përkorë. Edi Rama është prezent në vende të ndryshme brenda 24 orëve (!!!), kurse media ndjek hokat dhe batutat më intime



me një grup njerëzish që i plotësojnë skenografinë Burrit të Shetit. Kaq mirë e përgatitur gjithçka saqëv Ramës i mbetet të ndërrojë xhupat sportivë dhe të verë në kor shumë banorë hallexhinj sesi u ka zgjidhur hallet. Këta nuk pakësohen por shtohen dhe shtohen kudo, që ai shkel. Më keq akoma, askush nuk e frenon këtë kinezëri, duke na i sjellë ta gjalla ditët e dik-

taturës.

Askush nga ana tjetër, ose mjeshtrit e tij të komunikimit, nuk i thonë se komunikimi bëhet duke e transmetuar mesazhin nga A te B dhe jo nga A te A. Zoti Rama është përgjegjës bashkë me administratën e tij për strukturat që ngre për të zgjidhur hallet dhe jo për zgjidhjet sporadike, të cilat bëhen me telefona dhe nga portali

i tij.

Por, qyqarët që u zgjidhen hallet nuk duan t'ja dinë. Ashtu si një masë e madhe presin nga Basha që protesta e 16 Marsit të jetë dita e fundit e Ramës si kryeministër. Ata duan thjesht të zgjidhin hallet e tyre. Në emër të një relaksi momental, të peshës që i hiqet, një qytetar i thjeshtë i këtij vendi është gati të thotë broçkullat nga më të mëdha.

Rama dhe kolegët e tij harrojnë se janë zgjedhur për të shërbyer dhe për të qenë kokulur. Jo, Rama nuk e kupton sepse nuk e kuptojnë dot dhe njerëzit e tij të komunikimit. Ndaj, në podiume del i ngazëllyer me hoka të sikletshme, shpërndara kudo, e që bëjnë të qeshin vetëm militantët.

Politika nuk është një cak, por konsiderohet një mjet. Në asnjë rast, nuk duhet konsideruar si një produkt, pasi përbën një proces. Është arti i qeverisjes. Ashtu si vlerat e tjera ka edhe falsifikimet e saj. Sot, kaq shumë theks i është vënë falsitetit, saqë rëndësia e së vërtetës është errësuar kurse politika tashmë na shfaq kuptimin e egoizmit dinak, në vend të shërbimit të singhtë, do të shprehej dikur Calvin Coolidge.

Kryeministri ynë nuk e kupton më se në çfarë udhe është futur, por edhe se ku po e drejton vendin. Dikush duhet ta ruajë Ramën nga deliri, sepse me këtë rast do të ruajë vendin nga kaosi, që e ka ngrëthyer. Dikush duhet t'i thotë se falsiteti shitur plot gjyra lëbyrëse, është aspak i lidhur me realitetin, që jetojmë.

Kjo të vinte ndërmend teksa dëgjoje delirin e tij me banorë e mbledhur në Fier dhe vaujtjen e militantëve të opozitës tutje, neveritur prej tij, që grishnin më kot të dëgjoheshin. (

Gazeta Shqiptare)

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE
LAJMET E FUNDIT NE
APARATIN TUAJ




INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID



Fjalëkryqi (1)



- HORIZONTAL
1. Humanisti i Rotterdami
6. Mund të jenë cigaresh.
12. Capirossi i MotoGP.
13. Eshhtë bixhoz
14. I vetmi në orar.
15. Para Diego në Kaliforni.
16. Fillojnë setfte.
17. Eshhtë makina për guidë.
21. Inicialet e Benigni-t.
23. Janë riparime.
25. Janë të brishtë.
27. Fillojnë largimin.
28. Ishin kambistë të dikurshëm.
29. Një motoskaq gare.
31. Kështu thirrje Marco Pantani.
32. Janë penjtë për moline.
33. Emër vajze.
35. Janë edhe ato të cirkut.
36. Nuk ka tradhtari.

- 37. Janë baballarët.
38. Fillojnë titrat.
39. Ai dhe ajo.
40. Mbledh basketë separatistë.
41. Fillojnë saldimin.
42. Gjysma e krahut.
45. Në krye të armatës.
46. Gjysmë krisme.
47. Jepet për hartim.

VERTIKAL

- 1. Paul që qe poet i famshëm.
2. Dennis i McLaren.
3. Këndohet në opera.
4. Gjysmë siklet.
5. Kufijtë e matjes.
6. I zhvillon kongresi.
7. Inicialet e Moravia-s
8. Janë krerë bandash.
9. Të fundit në tender.
10. Fund shkurti.
11. Mund të jenë grosistë
13. Ka shirit magnetik një e tillë.
15. Ishin engjëj të korit të lartë
17. Janë gjynahet
18. Bega komik.
19. Janë shemra.
20. Inicialet e Morricono-s.
22. Janë edhe ato fetare.
23. Një gjuajtës francez.
24. Gjika e Dora D'Istria-s.
26. Qytet grek.
29. Bëjnë katrorë me një kat.
30. Ishin ndjekësit e Antistenit.
32. Shkruhet i treti.
34. Një sulm... kardiak.
36. Ki Moon i OKB
40. Inicialet e Rohmer.
43. Robert Mitchum.
44. Dy asa.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- 1. Bëhet një me psonisje.
5. Një mund të jetë qeveritar
11. Maiden që këndojnë.
13. Një ushtarak është solemn.
15. Inicialet e Mann shkrimtar nobelist.
16. Teket pa kufij.
18. Mbetet në fund.
21. Një mongol i Timurlengut
23. Një peskë i rëndë.
25. Tiriac ish-tenist
26. Kufizojnë një takim.
27. U hodhën në Tartar nga Zeusi
30. Fillojnë nazet
31. Kalimi në krye.
32. Ishte gruaja që i dha ujë nga pusi Jezusit.
34. Janë portet.
35. Dashi kur mungon ai
37. Javier, shefi i diplomacisë së BE
38. Kufizohet në kufij
39. Ente Civile Europiane.

VERTIKAL


- 40. Një birrë.
41. Mbetur në fund.
42. Ramazzotti këngëtar
43. Janë në modë.
44. Janë tek në shaka.
45. Eshhtë dite në mbledhje.
47. Një pjesë e kandidaturave.
49. Jessica Parker aktore.
50. Inicialet e Presley.
51. Akoma është ndryshe.
52. Janë brinjët në skuadër.
53. Qender fitimi.
1. Brad aktor.
2. Komandohet nga gjenerali.
3. Në hyrje të zonës
4. Janë në skajë
6. Janë librat e parë
7. Mund të jetë arme.
8. Inicialet e Turgeniev.
9. Ndërmarrje Industriale Tiranë.
10. Mund të lakohet.
12. Janë araknidet si vejshua e zezë.
14. Mund të jetë e lirë në port.
17. Një mjet lundimi.
20. Shkroi Rinoceronti.
22. Ekstremit në ritëm.
24. Kalohen në gjumë.
28. Filmi i parë shqiptar.
29. Fillojnë takimet
31. Kufizojnë kënde.
32. Një depozitë drithi.
33. Janë vendet e para.
34. Një parabolë e tenisit.
36. Eshhtë logari që qerohet.
37. Shteti me Khartum.
38. Janë kapot e bandave.
40. Një thirrje e dëshpëruar nga direku.
41. Lidhin brigje.
42. Një lidhëz
46. King Cole i muzikës.
48. Fillojnë ndeshjen.
49. Sapo fillojnë.
50. Mbetet në fund.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

PERGJIGJET E FJALEKRYQJEVE TE NUMRIT TE KALUAR
MARNITIE PRMITTE
INATU MADTES
STUTS ENDERERE
TELTUNDIMIAU
ENKENDIMISS
RAAFJOEBELA
ITAKANAANNAKI
OKANAISARNA
ZELLI LIMEDE
EBARITONTOR
TOKAALNTERA
MINIMALLESTER
AVATI SALAMINA
LANA FEARIS
ALNENENAPTOP
NEGERSIRATBI
TASMODEUMIR
SAMTARAFEDA
MRONINARIEET
HABERTOMARA
RITSEKRIETET
TEMEBELITV
OTMERITATSAM
MARIANNAARMANI

SUDOK

5 4 8 2
1 9 5
6 3
3 9 8
6 5
2 7
4 1 6
9 5 1

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6 8 7 4 5 1 9 3 2
4 3 9 8 2 6 7 1 5
5 2 1 9 3 7 4 6 8
2 4 6 1 8 3 5 7 9
7 9 5 6 4 2 1 8 3
3 1 8 7 9 5 2 4 6
8 7 2 5 6 4 3 9 1
1 6 3 2 7 9 8 5 4
9 5 4 3 1 8 6 2 7

Argëtim filozofik

- Njerëzit thonë se e duan shiun, por hapin çadrat kur bie shi! Njerëzit thonë se e duan diellin, por kërkojnë hije kur dielli del! Njerëzit thonë se e duan erën, por kur era fryn dritaret janë të mbyllura! Prandaj dhe unë buzëqesh kur dëgjoj njerëzit të thonë se më duan!
- "Varfëria nuk të lë ta ngresh kokën. Dinjiteti nuk të lë ta ulësh ..."
- Ndonjëherë njerëzit hedhin diçka të mirë për diçka më të mirë, për të zbuluar më vonë se e mira ishte njëjtë e mirë, dhe më e mira ende nuk ka ardhur.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME Përgjigja e numrit të djeshëm

Grids for Kriptoskeme puzzles with letters and numbers.

Thënie të mençura

- "Nuk ka ndjenjë më të mirë se të duash, të duash dhe të jetosh çdo sekondë të jetës tënde
Mos e humbini kurrë kuptimin e jetës, thjesht shijoni çdo impuls të ditës sikur të ishte rrahja e fundit e zemrës suaj"
- Nëse në të njëzetat nuk mëson, në të tridhjetat nuk bën.
në të dyzetat nuk keni, atëherë në të pesëdhjetat as nuk do të mësosh, as nuk do të bësh, dhe as nuk do të keni.
Eshhtë lakmi të flasësh për çdo gjë dhe të mos duash të dëgjosh për asgjë.

